

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 11-2019

Politikat Lokale – Bashkëpunimi Ndërkomunal në Kosovë

Muhamet Bytyçi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

Recommended Citation

Bytyçi, Muhamet, "Politikat Lokale – Bashkëpunimi Ndërkomunal në Kosovë" (2019). *Theses and Dissertations*. 26.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/26>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



UBT College

Faculty for Public Policy and Management

Diploma Thesis

Local Policies – Inter municipal Cooperation in Kosovo

Level of studies: Master

2014-2015 Academic year

Student: Muhamet Bytyci

Mentor: Dr.Enver Krasniqi

Co-mentor: Dr.Ermal Lubishtani

This thesis has been drafted and submitted in partial fulfillment of the requirements for the Master's Degree

November, 2019 Prishtina



Kolegji UBT

Fakulteti për Politika Publike dhe Menaxhim

Punim Diplome

Politikat Lokale – Bashkëpunimi Ndërkomunal në Kosovë

Niveli i studimeve: Master

Viti akademik 2014-2015

Studenti: Muhamet Bytyçi

Mentor: Dr. Enver Krasniqi

Co-mentor: Dr. Ermal Lubishtani

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallën Master

Nëntor, 2019 Prishtinë

ABSTRACT

Local policies and municipality decision making mechanisms are integral part of public and political institutions of democracies. Aside from traditional local responsibilities that municipalities have, there are a number of other aspects that fuel dynamics of development of local policies.

The inter municipality cooperation policy has proved successful in terms of results, as an effort to establish a system of appropriate and progressive communication between municipalities in Kosovo. It helped in exchange of experiences in joint duties, generating multilateral trust and softening inter party, ethnic and ideological differences.

This scientific work provides an analytic approach about local policies in the Republic of Kosovo with particular focus on inter municipality cooperation policy. There is a wide experience of cases in regards to the extensive rights that municipalities have on internal and international cooperation as defined by law. The law empowers municipalities to cooperate in wide range of modalities including the establishment of associations of municipalities to protect and advance their common interests.

Inter municipality cooperation is based on the free will of municipalities to enter into cooperative relations to facilitate share of roles, responsibilities and resources of municipalities for the needs of cooperation.

The Kosovo experience so far has two categories of inter municipality cooperation:

Inter municipality cooperation among municipalities within the state and international cooperation among municipalities of other states. Yet, the object of the study in this scientific work is inter municipality cooperation among municipalities within the Republic of Kosovo. As such, the objective of this study is dealing with cooperation among municipalities with the state. Inter municipality cooperation is the core issue handled in this research.

Key words: Municipality, Inter-municipal Cooperation, Local Policies, Local Government.

ABSTRAKT

Politikat lokale dhe mekanizmat e vendim-marrjes komunale janë pjesë përbërëse e institucioneve politike publike të çdo vendi demokratik. Përveç karakteristikave lokale tradicionale të detyrave që kanë komunat, janë edhe disa aspekte të tjera që i japin dinamikë zhvillimit lokal të politikave komunale.

Një nga politikat që ka dhënë rezultate duke ndihmuar në shkëmbimin e përvojave, në punët e përbashkëta, në krijimin e besimit shumëpalësh dhe në uljen e dallimeve partiake, etnike dhe ideologjike në përpjekjen për një sistem komunikimi të drejtë e progresiv në mes të komunave në Kosovë është edhe politika e bashkëpunimit ndërkomunal.

Ky punim ofron një qasje analitike rreth politikave lokale në Republikën e Kosovës, duke u fokusuar në politikën e bashkëpunimit ndërkomunal. Praktikrat e njohura flasin për të drejta të pakufizuara të bashkëpunimit të brendshëm dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të komunave për kompetencat që i kanë të përcaktuara me ligj. Ligji u jep të drejtë komunave në formimin e asociacioneve të komunave për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta dhe bashkëpunimin në shumë forma të tjera.

Bashkëpunimi ndërkomunal bazohet në vullnetin e lirë të komunave për të krijuar marrëdhënie të bashkëpunimit, duke krijuar ndarjen e roleve dhe resurseve komunale për nevojat e bashkëpunimit.

Në praktikën e Kosovës ekzistojnë dy kategori të bashkëpunimit ndërkomunal:

Bashkëpunimi Ndërkomunal, mes komunave të të njëjtit shtet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërmjet komunave të shteteve të ndryshme. Por në këtë punim objekt trajtimi është bashkëpunimi ndërkomunal në mes të komunave të Republikës së Kosovës. Pra objektivi i këtij punimi është trajtimi i bashkëpunimit të brendshëm në mes të komunave.

Bashkëpunimi Ndërkomunal është çështja thelbësore e trajtuar në këtë hulumtim.

Fjalët kyçe: Komuna, bashkëpunimi ndërkomunal, politikat lokale, pushteti lokal.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Një numër institucionesh, përfaqësuesish e bashkëpunëtorësh meritojnë mirënjohjen për këtë hulumtim. Pa mbështetjen e tyre dhe gatishmërinë për të më ndihmuar nuk do mund të arrija synimet e mia.

Kryetarit të Kamenicës, Qëndron Kastrati, ish-shefi i kabinetit të tij, Nol Nushit; Blerta Krasniqi, shefe e kabinetit të Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, asambleistit të Komunës së Suharekës, Leonard Shala, asambleistes së Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe anëtares së kabinetit të Kryetarit të Prishtinës, Mimoza Sylejmanit, profesorit Dr. Avdi Smajllajt, nga i cili kam mësuar shumë për çështjet e demokracisë dhe të përgjegjësisë profesionale.

Gjithashtu dua të shprehë vlerësim dhe mirënjohje të sinqertë për Prof. Enver Krasniqin për udhëzimet gjatë punës në këtë hulumtim, të cilat janë më se të çmuara për mua.

Falënderim i veçantë u takon edhe institucioneve, organizatave e individëve, përkatësisht komunave pjesëmarrëse të këtij hulumtimi, Prishtinës, Kamenicës, Malishevës, Gjilanit, Ranillugut, Novobërdës, Obiliqit dhe Suharekës, të cilat më kanë ndihmuar pa hezitim.

Mirënjohje e thellë i takon familjes time për mbështetjen e tyre të pakushtëzuar gjatë studimeve dhe punës time profesionale e angazhimit publik.

Në fund mirënjohje e respekt për të gjithë koleget e mi ndër vite, me të cilët kam punuar duke ndarë shumë përvoja dhe duke mësuar në ecje për politikën publike dhe implementimin në praktikë të tyre, për pushtetin lokal, për marrëdhëniet ndërpersonale e profesionale si dhe për kritikën që kam marrë në vazhdimësi nga ata.

Pa marrëdhëniet dinamike ndërvepruese profesionale me një rrjet bashkëpunëtorësh sigurisht që edhe ky punim do ishte shumë më i mangët.

Përmbatja

LISTA E SHKURTESAVE.....	VII
1.HYRJE.....	0
2.SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	1
2.1.POLITIKAT PUBLIKE LOKALE NË KOSOVË	2
2.2 POLITIKAT PUBLIKE	4
2.3 PUSHTETI LOKAL DHE RREGULLIMI NORMATIV	5
2.4 KOMPETENCAT E KOMUNAVE NË KOSOVË	6
2.5 MBIKQYRJA E AUTORITETEVE LOKALE	7
2.6 KOMPETENCAT VETANAKE TË KOMUNAVE	8
2.7 KOMPETENCAT E DELEGUARA	9
2.8 KOMPETENCAT E ZGJERUARA.....	10
3.DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	11
3.1 FORMAT POTENCIALE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL.....	12
3.2 TËRSIA E RREGULLAVE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL NË KOSOVË	13
3.3 FORMAT SI ZBATOHET BASHKËPUNIMI	15
3.4 FINANCIMI DHE MBIKËQYRJA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL.....	17
4.METODOLOGJIA.....	18
5.PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	19
5.1 KOMUNA E KAMENICËS	20
5.2 MARRËVESHJA NDËRKOMUNALE TË KOMUNËS SË KAMENICËS.....	22
5.3 MARRËVESHJA NDËRKOMUNALE NË MES TË KOMUNËS SË KAMENICËS DHE KOMUNËS SË GJILANIT	22
5.4 MARRËVESHJA E KOMUNËS SË KAMENICËS DHE RANILLUGUT	24
5.5 MARRËVESHJET E KOMUNËS SË NOVOBERDËS.....	25
5.6 KOMUNA E MALISHEVËS	27
5.7 KOMUNA E SUHAREKËS	30
5.8 KOMUNA E PRISHTINËS	31
5.9 UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE	32
5.10 TAKIMI I PRISHTINËS	34
5.11 DEKLARATA E UNIONIT TE BASHKIVE SHQIPTARE	35

5.12 TAKIMI I TETOVËS	36
5.13 ANALIZA E REZULTATEVE	38
6.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	40
6.1 SHKËMBIMI I PËRVOJAVE	40
6.2 REFORMA SEKTORIALE.....	41
6.3 REFORMA NË DIGJITALIZIMIN E ADMINISTRATËS	41
6.4 DOKUMENTACIONET DHE PERKTHIMET.....	41
6.5 MARRËVESHJET PËR INVESTIME TË PËRBASHKETA	41
6.6 INVESTIMET NË INFRASTRUKTURË	41
6.7 MBROJTJA E MJEDISIT	42
6.8 QASJA NË FONDE	42
6.9 INVESTIME NE PAISJE DHE TEKNOLOGJI.....	42
6.10 BASHKËPUNIMI NË TURIZËM.....	42
6.11 PËRMBLEDHJE	43
REFERENCAT	44

LISTA E SHKURTESAVE

KEVL - Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale

LVL - Ligji për Vetëqeverisjen Lokale

VQL - Vetëqeverisje Lokale

SVQ - Sistemi për Vetëqeverisjen

MAPL - Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal

LBN - Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal

BNK - Bashkëpunim Ndërkomunal

LPFL - Ligji për Financat e Pushtetit Lokal

AKK - Asociacioni i Komunave të Kosovës

UNDP - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin

UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosove

MDIS - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike

MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë

BE- Bashkimi Evropian

1.HYRJE

Pushteti lokal konsiderohet adresa e parë e takimit të qytetarit me autoritetin shtetëror e publik. Nga aty fillon marrëdhënia e ndërtimit të raportit qytetar - institucione publike. Rëndësia e pushtetit lokal është parë me interesim në shumë vende që synojnë të ndërtojnë institucione demokratike dhe në shërbim të interesit qytetar. Në përpjekjen për të analizuar dhe studiuar disa fenomene të qeverisjes lokale, në këtë punim kemi analizuar dhe hulumtuar disa nga këto.

Pjesa e parë e punimit trajton shkurtimisht politikat publike, me theks të veçantë politikat publike lokale në Kosovë. Në këtë kapitull është paraqitur rëndësia e politikave publike lokale. Një pjesë e kapitullit të parë dhe e kapitullit të dytë qartëson kompetencat që kanë komunat në Republikën e Kosovës, duke i ndarë në kompetencat vetanake, kompetencat e deleguara dhe kompetencat e zgjeruara, që janë karakteristikë për disa komuna me shumicë serbe dhe që nuk janë të transferueshme tek ndonjë subjekt tjetër.

Në kapitullin e tretë është trajtuar rëndësia e bashkëpunimit ndërkomunal. Mundësitë dhe përparësitë që kanë komunat e Kosovës në këtë politikë, duke paraqitur një shumësi fushash, ku bashkëpunimi ndërkomunal është mundësi për zhvillim të qëndrueshëm të komunave.

Në kapitullin e katërt janë paraqitur rastet e hulumtimit të marrëveshjeve që kanë pasur disa nga komunat që kanë qenë edhe mostër e këtij hulumtimi si: Komuna e Kamenicës, Malishevës, Prishtinës, Suharekës, Obiliqit, Parteshit, Novobërdës dhe Klinës, Pejës, Istogut dhe Gjilanit në vetëm një marrëveshje.

Në kapitullin e pestë është paraqitur modeli i bashkëpunimit rajonal në mes të komunave shqiptare në rajon, shembulli i “Unionit të Bashkive Shqiptare” që është marrëveshje ndërkomunale e Bashkive në Shqipëri dhe Komunave në Kosovë, Maqedoni Veriore, Malin e Zi dhe Serbi, si Tirana, Prishtina, Tetova, Prizreni, Presheva, Ulqini, Çairi, Vlora dhe Tuzi, që është një iniciativë rajonale për bashkëpunim ndërkomunal.

Në kapitullin e fundit është paraqitur një analizë për bashkëpunimin komunal të bazuar në gjetjet e mostrës së këtij studimi, duke specifikuar disa nga fushat ku mund të bashkëpunojnë Komunat e Kosovës dhe mundësitë që kanë në këtë drejtim.

2.SHQYRTIMI I LITERATURËS

Kur një Kryetar rrethi apo komune dërgon një skuadër punëtorësh për të mbushur gropat e hapura nga ngrica në rrugët e rrethit, kemi të bëjmë me administrim. Administrata është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve. Por kur bëhet fjalë për cilën pjesë të rrugës parashikohet të zgjerohet, aty fillon politika. (Epler E, Rikthimi i Politikës, ISPS dhe Rinia 2000, Tiranë)

Qeverisja lokale është një koncept i gjerë dhe është përkufizuar si formulim dhe ekzekutim i veprimit kolektiv në nivel lokal.

Qëllimi i saj është të sigurojë përdorim efikas dhe eficient të burimeve publike dhe të kryej shërbime në nivelin më të afërt për qytetarët. Çdo shtet për zhvillimin e konceptit të pushtetit vendor zgjedhë teorinë më të përshtatshme të qeverisjes vendore.

2.1 POLITIKAT PUBLIKE LOKALE NË KOSOVË

Ky punim është bazuar në një analizë të modelit aktual të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes lokale në Kosovë në të dy nivelet dhe më pas është bërë një përpjekje për të treguar modelet e reja të zhvillimit dhe të organizimit, por me theks të veçantë bashkëpunimin ndërkomunal, duke evidentuar sfidat dhe mundësitë e krijimit të bashkëpunimit të qëndrueshëm dhe me përfitime për komunat e përfshira në të.

Politikat e bashkëpunimit janë analizuar në atë se çfarë ka ndodhur deri tash në ato komuna, që kanë qenë mostër e studimit, por edhe në mundësitë e potencialin për të ardhmen.

Kërkimet analitike dhe modelimi i politikave lokale të bashkëpunimit ndërkomunal në Kosovë, tregojnë që komunat që kanë pasur përpjekje në këtë drejtim kanë për qëllim rritjen dhe të kuptuarit e konkurrueshmërisë në një kohë shumë dinamike, zbutjen e pabarazive hapësinore dhe social-ekonomike midis tyre dhe zhvillimin e përbashkët në një vend të vogël, siç është Republika e Kosovës me 38 komuna dhe zë një sipërfaqe afërsisht 10,900 km². (<https://www.kosovo-mining.org/kosova/gjeografia/>)

Qeverisja lokale është e përcaktuar me ligj, por në mes të gjithë detyrave ligjore aty ekziston një mundësi e madhe për punë, duke pasur një liri në vendimmarrjen e afërt me njerëzit e komunitetit.

Një kryetari komune i lejohet një fantazi në projektimin e përbashkët të Komunës. Ai mund të bëjë detyrë publike diçka për të cilën të tjerëve nuk u ka shkuar mendja. Ai mund të nxisë ngritjen e një rrjeti rrugësh për biçikleta, sigurisht aprovimi merret edhe nga Kuvendi Komunal dhe instancat tjera vendimmarrëse. Mund të përpiqet për një politikë të caktuar ekonomike, ekologjike apo edhe energjetike, mund të ideojë plane urbanistike e reforma në menaxhim e administrim të punëve komunale, mund të vendosë objektiva të cilat me angazhim e bashkëpunim edhe mund t'i arrijë.

Pushteti lokal përmes politikave publike mund të arrijë objektiva që do të ndikonin thellësisht në transformimin e një komuniteti dhe të japë një autonomi për realizim të ideve që qëllimin e fundit e kanë shërbimin, orientimin, zhvillimin e frymëzimin e njerëzve të atij komuniteti.

Politikat publike lokale janë tërësia e aktiviteteve të planifikuara nga qeveria lokale apo akterët e tjerë, që mbulojnë fushën e qeverisjes lokale. Në praktikën e shteteve demokratike siç është Republika e Kosovës, politikat publike lokale dhe mekanizmat e vendim-marrjes janë pjesë përbërëse e institucioneve politike, institucionale, kulturore e ekonomike.

Format e përmirësuara të përfaqësimit, metodat e reja të konflikt-menaxhmentit dhe nevojat për shërbime speciale janë pjesë e operimit ditor të qeverisë lokale. Çështjet ekonomike, çështjet me grupet e rrezikuara, çështjet me pakicat kombëtare, çështjet e ambientit, menaxhimin të mbeturinave, menaxhimin fiskal apo edhe të menaxhimit të pronës dhe një sërë çështjesh tjera që ndërlidhen me jetën e përditshme të banorëve të komunës janë sot detyrat dhe sfidat e qeverisjes lokale.

Të gjitha këtë tema janë sifida për të cilat komunat prodhojnë politika publike lokale që u japin zgjidhje këtyre problemeve.

Furnizimi i shërbimeve lokale në transformimet e shtetit të ri të pas vitit 1999 pësoj një transformim masiv në ambientin ekonomik që tashmë ishte në disa sektorë i privatizuar. Modeli i ri i shtetit dhe ekonomisë së lirë të tregut e paraqiti nevojën për funksione të reja administrative qeverisëse lokale nga shërbime publike me mbulueshmëri të lartë dhe kontrollit të shtetit, në shërbime të kombinuara ku erdhi në shprehje një qasje që disa shërbime të kryhen nga biznesi privat.

Në këto rrethana u paraqit nevoja për personel të kualifikuar dhe për një administratë më dinamike. Pra ndryshimi i sistemit politik e ekonomik ishte ndryshim edhe në qasjen e politikave publike lokale që ndryshuan rrënjësisht dhe përmbajtësisht në Kosovë.

Në kontekstin e zhvillimeve dhe ndryshimeve të sistemeve dhe të orientimeve evropiane edhe Qeverisja lokale në Republikën e Kosovës në orientimin dhe planifikimin e politikave publike lokale, një element të rëndësishëm në agjendën e reformave në vazhdimësi e ka pasur efikasitetin e lartë të shërbimeve të qeverisjes lokale, teknikat më të përsosura të menaxhimit dhe zhvillimin e etikës moderne administrative.

Mjafton të shihen ndryshimet në fushën e transparencës komunale, ku është bërë shumë në rregullativën që obligon për transparencë, pastaj në shërbime të shpejta si dhe në komunikimin me qytetarin përmes platformave të ndryshme elektronike.

Kosova sot njih shembuj të komunave që kanë arritur transparencë në publikim e qasje në dokumentet dhe politikat që nxjerrin deri në 100%. (Komuna e Prishtinës e prezanton si model platformën "open data" tek ekzekutivi dhe asambleistët e Komunës së Gjilanit) (Komuna-e-prishtines-e-prezanton-si-model-platformen-open-data-tek-ekzekutivi-dhe-asambleistet-e-komunes-se-gjilanit dhe KDI: Komuna e Prishtinës më transparentja)

Niveli i garantuar i autonomisë lokale është poashtu në mesin e elementeve themelore të ndryshimeve institucionale dhe demokratizuese. Krahas strukturave të reja janë rregulluar edhe sistemi i mirëfilltë elektoral demokratik për pushtetin lokal, që siguron mbrojtjen demokratike të zgjedhësve. (Vlerësime pozitive për zgjedhjet në Kosovë. Radio Evropa e lire)

Republika e Kosovës sot ka ndërtuar një rregullativë institucionale që fillon nga Ministria e Pushtetit lokal deri te Komuna. Kjo praktikë ka bërë të mundshëm kontrollimin dhe legalitetin e të gjitha akteve të qeverisjes lokale.

2.2 POLITIKAT PUBLIKE

Në teoritë e Shkencave politike ekzistojnë shumë definicione për politikat publike. Në këtë punim janë përmendur vetëm disa përkufizime të disa autorëve për politikat publike, duke mos e zgjeruar trajtimin e kësaj tematike.

Politikat publike, në kuptimin e përgjithshëm, shihen si vendime formale e legale të instancave qeveritare. Politikat e tilla janë të lidhura mes synimeve, veprimeve dhe rezultateve.

Të gjitha përkufizimet për politikat publike tentojnë të venë theksin ose mbi aktorët e pajisur me pushtet publik, ose mbi problemet kolektive që duhen zgjidhur, ose mbi veprimet shtetërore që duhet të kryhen.

Politika publike merret pra, me përcjelljen e vendimeve që nga krijimi i ideve deri te vlerësimi, korigjimi, plotësimi apo edhe zbatimi i tyre. Kjo do të thotë se nga një varg opsionesh për marrjen e vendimit, zgjedhet njëra prej tyre, për arsye të ndryshme (p.sh. kosto e ulët, zbatueshmëria e lehtë apo vullneti i shtuar politik), për të cilën gjë miratohet vendimi i prerë, dhe për të cilin pastaj miratohet një plan i veçantë veprimi. (Baliqi B, Politikat Publike dhe Qeverisja. Prishtinë: Fondacioni Konrad-Adenauer.)

Objektivat kryesore dhe thelbësore të studimeve të politikave janë: a. të kuptuarit shkencor të vendimeve, përmbajtës dhe pasojave të politikave; b. këshillimi brenda sektorëve e fushave të caktuara për krijimin dhe përmirësimin e politikave; c. dhe rekomandime të veçanta ose specifike për politikat nga ekspertët. (Baliqi B, Politikat Publike dhe Qeverisja)

Sot përpjekja është për specifikimin dhe profilizimin sektorial të politikave publike. Nënndarjet dhe definimet me karakter operacional të një apo disa politikave publike.

Siç e theksuam edhe në fillim trajtimi i zgjeruar i Politikave publike nuk është qëllimi i këtij hulumtimi. Por ishte shumë e nevojshme të bëjmë një hyrje bazike për politikat publike në përgjithësi, për të kaluar te politikat publike lokale në veçanti.

2.3 PUSHTETI LOKAL DHE RREGULLIMI NORMATIV

Korniza ligjore për VQL është e bazuar në parimet e Kushtetutës së Kosovës (Kuvendi i Kosovës: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, Prill 2008, kapitulli X, neni 123, pika 4) dhe të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (KEVL) (Council of Europe Publishing: “European Charter of Local Self – Government”, neni 4, pika 1.

Me nenin 123 të Kushtetutës, pika 4 janë caktuar parimet bazë të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, si: qeverisja e mirë, transparencë, efikasiteti dhe efektiviteti në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave të komuniteteve, të cilat nuk janë popullsi shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ndërtimi dhe zhvillimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale (SVQL) u bazua në parimet e vlerave evropiane për qeverisje lokale, por duke ua përshtatë nevojave dhe zhvillimeve politike të vendit. Derisa në shumicën e vendeve të rajonit dhe më gjerë ndërtohen sisteme duele të vetëqeverisjes lokale, Kosova zgjodhi sistemin e thjeshtë një shkallësh të VQL.

Ky sistem përfaqësohet vetëm nga të zgjedhurit e qytetarëve të komunës përkatëse dhe pushteti qendror nuk emëron përfaqësuesit e vetë në bashkëqeverisje.

Qytetarët vullnetin për udhëheqjen e tyre për një mandat prej 4 vjetëve e delegojnë në dy organe të pushtetit lokal në Kuvendin e komunës dhe në Kryetarin e komunës. (Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal. <https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2018>)

Institucioni i Kryetarit të komunës dhe Kuvendi komunal janë dy organet kryesore të inicimit dhe përpilimit të politikave lokale. Sigurisht edhe pushteti qendror ka një influencë në orientimet strategjike kombëtare, që prekin edhe interesin lokal. Mirëpo këtu do të shtjellojmë vetëm kompetencat që ka komuna dhe obligimet që dalin nga tërësia e dokumenteve juridike e politike të këtij niveli të qeverisjes.

2.4 KOMPETENCAT E KOMUNAVE NË KOSOVË

Kompetencat e Komunave të Kosovës janë të përcaktuara me Kushtetutë, ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Por, para se të definojmë kompetencat e komunave dhe ndarjet e tyre, po i përmendim shkurtimisht etapat e përcaktimit të këtyre kompetencave. Zhvillimi i Kornizës ligjore të pas vitit 1999 për vetëqeverisjen lokale në Kosovë.

Kjo periudhë mund të ndahet në tri pjesë:

1. Periudha e administrimit të komunave me Administrator komunal, sipas Rregullativave të UNMIK-ut, nga viti 2000 deri më 2002; Rregulloren Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës. (Rregullore nr 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës. http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_45.pdf)
2. Periudha e administrimit të komunave pa administrator komunal sipas Rregulloreve të UNMIK-ut dhe akteve tjera ligjore të IPVQ, me transferim të kompetencave në organet e vetëqeverisjes lokale, gradualisht nga viti 2002 deri më 2007.
3. Periudha e vetëqeverisjes lokale sipas Kushtetutës dhe Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nga 2008 deri sot.

Duke u bazuar në këto të dhëna, mund të konstatojmë se aktet bazike ligjore për ndërtimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, janë nxjerrë nga UNMIK (1999 – 2007) dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008 dhe tutje). ([https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2018/03/Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë](https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2018/03/Organizimi_dhe_funksionimi_i_vetëqeverisjes_lokale_në_Kosovë), faqe 8)

Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, si ligj organik apo themelor për organizimin dhe funksionimin e VQL në Kosovë përcakton edhe normat dhe standardet për një VQL e cila bazohet në 4 shtylla kryesore:

1. Demokracia lokale (zgjedhja e organeve komunale);
2. Pushteti i autoriteteve lokale (autonomia lokale)
3. Organizimi dhe funksionimi i SVQ

2.5 MBIKQYRJA E AUTORITETEVE LOKALE

Mbikëqyrja e autoriteteve lokale behet përmes ligjit për vetëqeverisje lokale. Ky ligj parasheh një rregullim proporcional të VQL duke baraspeshuar vendimmarrjen lokale në formë të parimit të demokracisë lokale. Derisa parimi themelor i vetëqeverisjes lokale është përfaqësimi i barabartë i qytetarëve në vendimmarrje, me këtë ligj dhe me Ligjin për zgjedhjet lokale, duke e përcaktuar komunën vetëm një zonë zgjedhore, qytetarëve u mundësohet përfaqësim proporcional vetëm nëpërmjet partive politike dhe iniciativave të qytetarëve, por jo edhe të vetë qytetarëve.

Me LVL komunës i janë dhënë tre lloje të pushteteve/kompetencave: pushtetin vetanak, pushtetin e deleguar dhe pushtetin e zgjeruar për disa komuna me shumicë serbe që nuk janë të transferueshme tek ndonjë subjekt tjetër. Kompetencat e deleguara hyjnë në grupin e kompetencave shtetërore dhe ato mund t'u merren komunave kur konstatohet se ato nuk kanë kapacitete për ushtrimin me cilësi të tyre. (Ligji për vetëqeverisje lokale neni 16,17,18,19.)

Po ashtu LVL iu ka dhënë më shumë kompetenca vetanake komunave duke i transferuar kompetencat fakultative (sipas rregulloreve të UNMIK) në kompetenca vetanake. Komunitat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit (Neni 10; Parimi i Subsidiaritetit). (Po aty. Neni 15)

2.6 KOMPETENCAT VETANAKE TË KOMUNAVE

Njëra ndër parakushtet më të rëndësishme të implementimit të suksesshëm të politikave publike lokale është definimi i qartë i kompetencave.

Në Republikën e Kosovës komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

a) zhvillimin lokal ekonomik; b) planifikimin urban dhe rural; c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin; d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; e) mbrojtjen e mjedisit lokal; f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësë lokale; g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale; h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor; k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale; l) banimin publik; m) shëndetësinë publike; n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë; o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapsirës publike; q) turizmit; r) aktivitetet kulturore dhe të lira; s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër; (Ligji për Vetëqeverisje Lokale, neni 17 Kompetencat Vetanake)

2.7 KOMPETENCAT E DELEGUARA

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës u delegojnë përgjegjësi komunave, në pajtim me ligjin, për kompetencat vijuese:

- a) shënimet kadastrale;
- b) regjistrimin civil;
- c) regjistrimin e votuesve;
- d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- f) mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

2.8 KOMPETENCAT E ZGJERUARA

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin. Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

a) Kompetencat e zgjeruara në perkujdesin dytësor shëndetësor (Neni 20) b) Kompetenca të zgjeruara në shkollimin universitar (Neni 21) c) Kompetencat e zgjeruara në fushën e kulturës (Neni 22) d) Të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore lokale (Neni 23). (Ligji për Vetqeverisjen Lokale neni 19, 20,21,22,23)

Bazuar edhe në definimin e kompetencave në rastin e Kosovës, por edhe në përgjithësi funksioni i përgjithshëm i Qeverisjes lokale është të përmbushë nevojat shoqërore, ekonomike, kulturore dhe edukative të popullsisë që jeton në komunë.

Sigurisht që të gjitha këto kompetenca si detyra që burojnë nga ligji marrin kuptim vetëm në momentin kur prodhojnë politika sektoriale që japin zgjidhje për problemet në komunitet. Zbatimi i legjislacionit dhe kompletimi me dokumente të tjera me fuqi nënligjore është zbatimi edhe pjesa e zbatimit në përditshmërinë e komunave.

Trajtimi i kompetencave të pushtetit lokal duke mos ju shmangur nën për nën dokumenteve shtetërore është edhe udhërrëfyese se deri ku mund të shkojë bashkëpunimi ndërkomunal.

Bashkëpunimi nuk duhet të tejkalojë këto kompetenca e as të realizojë detyra jashtë këtyre kompetencave që Kushtetuta dhe ligjet i kanë dhënë pushtetit lokal.

3.DEKLARIMI I PROBLEMIT

Bashkëpunimi ndërkomunal është një praktikë e punës së dy apo më shumë komunave për qëllime të interesit publik në të mirë të qytetarëve dhe komunave që hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi. BNK nuk është një proces i bashkimit të komunave, por është proces i punës së bashku për të krijuar hapësirë më të madhe të mundësive për komunat që përfshihen.

BNK nënkupton bashkimin e dy ose më shumë njësi lokale për të siguruar shërbime publike. Kjo përbën një alternativë nëse fragmentimi territorial hasë në një rezistencë për të kryer reformë bashkimi. (Council of Europe, “Balancing Democracy, Identity and Efficiency: Changes in local and regional structures in Europe”, 23.04. 2009)

Nevoja për një bashkëpunim të tillë lind nga mundësitë e limituara financiare si dhe kapacitetet e pamjaftueshme të njësisive të vogla apo edhe të tjerave për të garantuar efikasitet në dhënien e shërbimeve publike si dhe për të siguruar ekonomi të shkallës ose gjeneruar eksternalitete në fusha si edukim, shëndetësi, furnizim me ujë, menaxhim i mbetjeve urbane, kulturë, emergjenca civile, rregulli publik, mbrojtje mjedisi, turizëm, investimeve infrastrukturore, fondeve të jashtme etj).

Avantazhi i bashkëpunimit lejon ruajtjen e autonomisë lokale kryesisht në lidhje me taksat dhe shpenzimet.

Bashkëpunimi ndërkomunal bazohet në vullnetin e lirë të komunave për të dinamizuar punën e tyre në rritjen e shërbimeve, arritjen e objektivave dhe krijimit të rrethanave për të vepruar bashkërisht për një shumësi temash që janë në interes të palëve.

Me bashkëpunim komunal, komunat nuk delegojnë përgjegjësi ligjore apo zëvendësim të organeve, por përmes bashkëpunimit ato shkëmbejnë përvoja, organizojnë punë që kërkojnë përfshirje më të madhe, bëjnë plane me karakter përtej territorit dhe zonës që janë në qeverisje.

Bashkëpunimi është mënyrë e funksionimit përmes një qasje të zgjeruar, ku mundësitë e përbashkëta të dy apo më shumë komunave organizohen në atë mënyrë që t'i shërbejnë një numri më të madh të njerëzve. Orientimi i tillë ka për synim arritjen e një sërë objektivash që kanë komunat në interes.

Bashkëpunimet ndërkomunale janë me karakter kombëtar, rajonal e ndërkombëtar.

Bashkëpunimi ndërkomunal nuk është i njëjtë në të gjitha vendet e botës, Bashkëpunimi ndërkomunal mund të ndryshoj në shtete të ndryshme varësisht nga ligjet, kultura, tradita apo modele të zhvillimit. (Manual/Toolkit on Inter-municipal Cooperation, (UNDP, Council of Europe, Local Government and Public Service Reform Initiative, 2010)

3.1 FORMAT POTENCIALE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

Aktualisht në Kosovë nuk ka një traditë të gjatë për bashkëpunim ndërkomunal.

Sipas studimeve teorike dhe empirike, interesi i politikanëve lokale në përfshirjen e iniciativave të bashkëpunimit ndërkomunal, shpesh varet nga niveli i decentralizimit të pushtetit në një vend.

Nëse reforma e decentralizimit zbatohet dhe autonomia lokale rritet edhe më shumë mund të fillojë të ndjehet presioni i nevojës për një investim të madh kapital në shërbimet në infrastrukturë, e cila tani është kompetencë e nivelit më të lartë të qeverisjes qendërore.

Ka tre aspekte të rëndësishme që konsiderohen kur përcaktohen funksionet e një bashkëpunimi ndërkomunal.

Së pari ky model nuk është ekskluziv vetëm për dy palë, por edhe për partnerë të tjerë.

Së dyti njësitë e qeverisjes lokale duhet të jenë fleksibil në zgjedhjen e partnerëve dhe të iniciativave të bashkëpunimit ndërkomunal që mund të marrin pjesë në të. P.sh. e njëjta komunë mund të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me komunën fqinje për furnizimin me ujë, mund të marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët për menaxhimin e mbetjeve urbane me një numër komunash të tjera dhe mund të jetë pjesë e një projekti për turizmin.

Së treti, një mangësi e mundshme e këtij bashkëpunimi është mbivendosja e funksioneve dhe përgjegjësia e limituar që duhet të adresohet në iniciativa bashkëpunimi për të mos i bërë gjërat më keq duke vendosur më shumë presion mbi njësitë e dobëta lokale apo rritjen e korrupsionit e papërgjegjësisë.

Aspektet financiare të bashkëpunimit ndërkomunal dhe funksionet e partneritetit. Partneriteti duhet të krijohet: në një nivel administrativ, midis dy niveleve të ndryshme administrative. Eksperienca ndërkombëtare tregon që qeverisja qendërore është më shumë e dëshiruar të alokojë burime financiare direkt partneritetit kur anëtarët janë nga nivele të ndryshme qeverisëse. Në qoftë se ekziston vetëm një nivel i qeverisjes lokale atëherë partneriteti mund të krijohet midis publikut dhe njësitë tjera.

Shembull marrim menaxhimin e mbetjeve, partneriteti është përgjegjës për riciklimin, kompostimin dhe trajtimin e mbetjeve dhe komunat janë përgjegjëse për mbledhjen e mbetjeve dhe paguajnë për të.

Në saje të bashkëpunimit dhe marrëveshjeve në trajtimin e një politike përveç bashkëpunëtorëve publikë në sektor të caktuar bashkërisht mund të përfshihen aktor jopublikë apo gjysmë publikë me qëllimin e efikasitetit në një segment të caktuar për të zbatuar një politikë të caktuar publike.

3.2 TËRSIA E RREGULLAVE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL NË KOSOVË

Ligji për bashkëpunim komunal

Komunat në Kosovë kanë të drejtë kushtetuese për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar sipas Kushtetutës, Nenet 124.pika 4. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 124. Pika 4. <http://ëë.kushtetutakosoves.info/>)

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet komunave është i rregulluar me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, i cili zgjeron Kapitullin V të Ligjit për vetëqeverisje lokale. (Ligji nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2749>)

Bashkëpunimi ndërkombëtar gjithashtu është parashikuar edhe me Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (Plani i Ahtisaarit) dhe garantohet me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Parimet bazë të bashkëpunimit ndërkomunal janë që komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komuna tjera të Kosovës brenda fushës së tyre të kompetencave për të realizuar funksione që janë në interes të përbashkët të tyre, të përmbushin qëllime të përbashkëta në ofrimin e shërbimeve publike komunale dhe të zhvillimit lokal.

Procedura për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal fillon ose me iniciativë nga kryetari i komunës nga 1/3 e këshilltarëve komunal, së paku 5% të qytetarëve të komunës me të drejtë vote; apo, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal Nenet. 6.2, 6.3).

Me këtë nënkuptojmë se sipas kornizës ligjore të vendit për themelimin e BNK nuk është i nevojshëm vetëm vendimi nga Qeveria e Kosovës por ai mund të nisët dhe të zhvillohet nga vetë komunat pjesëmarrëse sipas procesit të përshkruar më lartë. Pra, bazuar në LBN- Neni 6.4 iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal duhet të mbështetet me të dhëna për qëllimin e bashkëpunimit, kompetencat që janë relevante për të, komunat e përfshira në këtë bashkëpunim, forma e bashkëpunimit, përfitimet e pritura, implikimet potenciale financiare që dalin nga ky bashkëpunim, si dhe çështje tjera të rëndësishme për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal.

Ligji për vetëqeverisjen lokale parasheh që komunat mund të ushtrojnë përgjegjësi komunale në fushat e kompetencave të tyre vetanake dhe të zgjeruara përmes partneriteteve komunale, (LVL, Neni 29.1).

Përjashtim bëhet për vendimet e mëposhtme, të cilat bien nën autoritetin e kuvendeve komunale dhe nuk mund të merren përsipër nga bashkëpunimet ndërkomunale:

Statutet apo rregulloret e punës dhe rregulloret komunale;

Miratimi i buxhetit dhe planeve të investimit;

Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;

Themelimi i komiteteve siç kërkohet me Ligjin për vetëqeverisje lokale;

Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zv. Kryesuesit të Kuvendit Komunal;

Niveli i tarifave dhe ngarkesave Komunale;

Krijimi dhe përdorimi i simboleve komunale, dekorimeve, dhe titujve të nderit;

Emërtimi dhe riemërtimi i rrugëve, rrugicave, dhe vendeve tjera publike;

Bërja e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda-komunale,

Anëtarësimi në asociacione përfaqësuese të komunave, (LVL, Nenet 29.1, 40 dhe LBN, Neni 4.2).

Këto akte normative nënkuptojnë që partneritetet komunale mund të krijojnë organe vendimmarrëse që marrin vendime në fushën e veprimeve të dakorduara nga komunat pjesëmarrëse, duke përfshirë financimin e partneriteteve (edhe pse buxhetet dhe planet vjetore të punës janë vendime të cilat komunat nuk mund t'ia delegojnë organeve tjera).

3.3 FORMAT SI ZBATOHET BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL

Format nëpërmjet të cilave mund të ushtrohet bashkëpunimi në formën e partneriteteve komunale janë:

- Trupat e përbashkët punues dhe komisionet për shqyrtimin e çështjeve të caktuara të përcaktuara nën kompetencat e komunës, (LBN, Neni 10);
- Trupat e përbashkët administrativë për kryerjen e kompetencave të caktuara komunale dhe kryerjen e punëve profesionale dhe administrative brenda kompetencave të përcaktuara me marrëveshje.

Komunat pjesëmarrëse caktojnë nëpunësit civilë për të punuar në trupin e përbashkët administrativ. Megjithatë, këto trupa nuk janë persona juridikë dhe përgjegjës të përfundimtare i mbeten komunave, (LBN, Neni 11).

Marrëveshja ndërkomunale nuk mund të themelojë departamente që do të zëvendësojnë autoritetin e kuvendeve komunale/drejtorive komunale;

- Ndërmarrjet e përbashkëta publike për kryerjen e shërbimeve publike në nivelin lokal, në përputhje me kushtet dhe procedurat e vendosura me Ligjin për ndërmarrjet lokale. (LBN, Neni 12);
- Institucionet e përbashkëta publike për kryerjen e aktiviteteve të caktuara të interesit publik dhe me rëndësi në fushat e arsimit, shëndetësisë, kulturës, mbrojtjes sociale, trashëgimisë kulturore, mjedisit, planeve të përbashkëta për mjedisin dhe fusha të tjera.

Kryetarët e të gjitha komunave pjesëmarrëse nënshkruajnë marrëveshje që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet reciproke në lidhje me institucionet publike. Vendimi për krijimin e një institucioni të tillë publik duhet të miratohet me shumicën e votave në kuvendet komunale, bazuar në verifikimin e burimeve të siguruara nga themeluesit, burimet e përhershme të financimit, të drejtat dhe detyrimet e themeluesit, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të institucionit dhe të themeluesve, kohëzgjatja e veprimeve, dhe në strukturën e organizimit dhe të menaxhimit të organizatës, (LBN, Neni 13);

- Partneritete të përbashkëta publiko-private për kryerjen e shërbimeve publike në nivelin lokal dhe sigurimin e infrastrukturës publike, në përputhje me legjislacionin për partneritete publike-private, (LBN, Neni 9);
- Ose një komunë mund t'i japë mandat, në bazë të marrëveshjes, një komune tjetër për të ushtruar kompetenca të caktuara, ndërsa mbetet përgjegjëse për të gjitha veprimet dhe aktet e ndërmarra nga komuna e mandatuar (LBN, Neni 14);

LBN në asnjë nga nenet, kapitull apo emërim kreu nuk e përcakton dallimin ndërmjet formave të bashkëpunimit ndërkomunal, supozojmë se të gjitha këto forma nuk kanë ndonjë dallim substancial në esencë sa i përket bashkëpunimit si veprim.

LBN po ashtu nuk e përcakton numrin e komunave të cilat mund të hyjnë në ndonjërin nga format e bashkëpunimit të parapara me dispozita ligjore e po ashtu nuk e përcakton dhe kufizon përbërjen etnike të anëtarëve të një asociacioni, që nënkupton ato mund të jenë monoetnike apo multietnike.

LBN gjithashtu nuk e kufizon kohen e bashkëpunimit ndërkomunal. Ligji ka krijuar hapësirë për rregullimin e përgjithshëm duke mos specifikuar shumë detaje që mund të rregullohen me marrëveshjet ndërmjet komunave.

LBN nuk e përcakton madhësinë territoriale, gjendjen e zhvillimit të përgjithshëm apo edhe numrin e banorëve të një komune për bashkëpunim.

3.4 FINANCIMI DHE MBIKËQYRJA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

Komunat përmes BNK zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe kanë si mundësi për t'i mbështetur financiarisht këto iniciativa përmes këtyre burimeve financiare:

- Përmes buxhetit të Republikës së Kosovës dhe ministrive të fushave përkatëse.
- BNK mund të financohen nga buxhetet e Komunave të cilat përmes një marrëveshje të qartë i kanë të caktuara përgjegjësitë e tyre financiare.
- Komunat që janë në bashkëpunim ndër komunal mund të aplikojnë për mbështetje financiare tek donatorët ndërkombëtar, përfshirë edhe fondet e BE-së. (Ligji nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)

MAPL-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, përcjellë zhvillimin e bashkëpunimit ndër-komunal si dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve financiare të dedikuara për zbatimin e BNK sipas legjislacionit në fuqi. BNK realizohet në bazë të kriterëve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, që pasqyrojnë formate suksesshme të bashkëpunimit përmes respektimit të parimeve: efektshmëria dhe cilësia e shërbimeve, qeverisja e mirë, proceset integrale dhe përfitimi i fondeve. Sa i përket buxhetit, ç'do bashkëpunim ndër komunal dhe bashkëpunim komunal ndërkombëtar duhet zbatohet duke respektuar ligjin për menaxhimin e financave publike, ligjin për prokurim publik si dhe legjislacionin sekondar që vjen si rezultat i ndonjë rregullore të brendshme apo udhëzimi administrativë. Sa i përket linjave buxhetore ato duhet të rregullohen sipas praktikave që i kanë komunat, gjithmonë në harmoni me udhëzimet/qarkoret buxhetore që vijnë nga Ministria e Financave.

Baza ligjore, praktikat e financimit, kompetencat e mirë definuara dhe shumë element të tjerë janë pjesë shumë me rëndësi për bashkëpunime të suksesshme ndërkomunalë.

4.METODOLOGJIA

Për këtë hulumtim janë përdorur metoda dhe teknika të cilat janë në përputhje të plotë me metodologjitë e kërkimit shkencor.

Librat, publikimet e organizatave të ndryshme për pushtetin lokal dhe qeverisjen, Ligjet dhe rregulloret, raportet e Instituteve dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, dokumentet publike dhe marrëveshjet ndërkomunale dhe ndërinstytucionale për disa komuna, janë materiale që e kanë ndihmuar dhe qartësuar idenë e këtij hulumtimi.

Intervistat dhe bashkëbisedimi me zyrtarë komunal, të zgjedhur në ekzekutivin e komunave, asambleistë dhe zyrtarë të tjerë të komunave që janë objekt i hulumtimit, janë pjesa kryesore e analizimit të këtyre gjetjeve.

Metoda e hulumtimit është metoda cilësore që është përdorur në forma të ndryshme, duke nxjerrë të dhëna objektive për temën e shtjelluar.

5.PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

RASTET E STUDIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

Në vazhdim do të paraqiten shembujt e deritanishme të bashkëpunimit Komunal në Kosovë. Si rast studimi janë komunat në vazhdim: Prishtina, Obiliqi, Kamenica, Novobërda, Ranillugu, Gjilani, Malisheva, Peja, Klina dhe Istogu.

Janë analizuar disa nga marrëveshjet për të parë nivelin e bashkëpunimit, fushat e bashkëpunimit, rezultatet e bashkëpunimit, dinamikën e bashkëpunimit dhe interesimin për bashkëpunim.

Bashkëpunimi Komunal është parë me shumë interes edhe nga zyrtarët komunalë të komunave që janë hulumtuar.

“Duke e ditur që komunat tona kanë buxhet të vogël për investime kapitale dhe duke marrë parasysh kërkesat e mëdha për investime nga komuniteti, bashkëpunimi ndërkomunal është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të investohet në projekte të përbashkëta në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve si dhe në rritjen e mundësive për përfitimin e projekteve dhe donacioneve nga organizata vendore e ndërkombëtare”. Sidomos bashkëpunimi i komunave fqinje është shumë i rëndësishëm bazuar në faktin që qytetarët e komunave kufitare shpesh marrin shërbime në komunat fqinje për shkak të afërsisë. (Krasniqi B, shefe e kabinetit të Kryetarit të Komunës së Malishevës. Intervistë e realizuar me datë: 10. Qershor 2019, Malishevë)

Por jo vetëm problemet financiare në investime, por edhe fakti që shumë komuna kanë ngjashmëri në problematikat e funksionimit të përditshëm, bashkëpunimi dhe dinamika e veprimeve të përbashkëta është pa si mundësi për një performancë më të mirë qeverisëse.

5.1 KOMUNA E KAMENICËS

Republika e Kosovës ka një infrastrukturë ligjore të konsoliduar sa i përket rregullimit të bashkëpunimit ndëkomunal.

Në vazhdim është trajtuar Komuna e Kamenicës si rast sa i përket bashkëpunimit ndëkomunal.

Mirëpo para se te fillojmë të trajtojmë marrëveshjet e bashkëpunimit ndëkomunal që ka Komuna e Kamenicës, po paraqesim disa nga informacionet kryesore për Komunën e Kamenicës.

Kamenica, si njësi e barabartë me komunat tjera në vend, statusin e Komunës e ka fituar në vitin 1959. Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës. Kufizohet në Jugë-Perëndim me komunën e Gjilanit, në Perëndim me komunën Novobërdës si dhe në Veri-Perëndim me Prishtinën. Në Veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskovcit, në Lindje me Vranjën dhe në Lindje dhe Jugë-Lindje me Bujanocin. (Komuna e Kamenicës, web faqja zyrtare. Datë 10.04.2019)

Pozita gjeografike e Komunës së Kamenicës është perimetrike në skajin më Lindor të Kosovës, por është urë lidhëse në mes magjistrales Gjilan-Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi 30 km, ndërsa Prishtina 75 km nga Kamenica. Me Prishtinën lidhet edhe me rrugë më të shkurtër, nëpër Novobërdë dhe Llabjan. Stacioni më i afërt Hekurudhor është në Ferizaj dhe Bujanoc. Aeroporti më i afërt është ai i Prishtinës 90 km dhe i Shkupit në Republikën Veriore të Maqedonisë 130 km.

Kamenica është vend kodrinoro – malor me disa lugina rreth lumenjve, me tokë aluviale shumë të përshtatshme për perimtari, dhe kultura tjera bujqësore. Këto shtrihen në pellgun e lumenjve Krivareka, lumit të Desivojcës dhe Hogoshtit nga ana veriore, kurse pjesa jugore shtrihet rreth lumit Anamorava.

Komuna e Kamenicës kryesisht ka qenë njohur në të kaluarën nga industria e materialit ndërtimor, pllakave te qeramikës dhe sintermagnezitet.

Mirëpo eksitojnë edhe kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë, tregtisë etj.

Karakteristikat kryesore të komunës janë:

- Një sipërfaqe prej 523 km²;
- Terren kodrinoro-malor 60%, dhe të rrafshëta (40%);
- Përshkohet nga lumenjtë: Krivareka, Lumi Hogosht dhe Morava e Binçës;

- Sipërfaqe te mjaftueshme për zhvillimin e bujqësisë me rreth 29 304 ha me kullosa, dhe livadhe 12.543 ha;
- Lidhje e mirë rrugore me magjistralen Gjilan – Bujanoc;
- Numri i banorëve në komunën e Kamenicës vlerësohet të jetë 36050 banorë;
- Në qytet jetojnë rreth 7831 banorë;
- Në fshatra jetojnë rreth 28219 banorë;
- Dendësia mesatare e popullsisë është 109 ban/km²;
- Rritja mesatare vjetore e popullsisë në këtë komunë është 0.29%;
- Ekziston dallim i vogël në strukturën gjinore me 51 % meshkuj dhe 49% femra;
- Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë 94.83%, serb 4.31%, romë 0.67%, Turqi 0.01%, Boshnjak 0.02%, Goran 0.08% dhe të tjerë (Vlerësim I bërë nga Agjencia Statistike e Kosovës);
- Vlerësohet se në komunën e Kamenicës, nga pjesa e popullsisë aktive 60-65% (mosha 16-65 vjeç). (Ëëb faqja zyrtare e Komunës së Kamenicës. Shikuar me datë 10.04.2019. <https://kk.rks-gov.net/kamenice/qyteti/historiku>)

Këto karakteristika që ka Komuna e Kamenicës përveç bashkëpunimit ndërkomunal i japin mundësi edhe për bashkëpunime të frytshme rajonale me komunat e shteteve fqinjë të Republikës së Serbisë dhe Republikës së Maqedonisë Veriore si zonë kufitare. Pozita gjeografike, përbërja etnike, raportet e kultivuara ndëretnikë etj., janë mundësi për bashkëpunime të frytshme edhe ndërkomunale, por edhe rajonale e ndërkombëtare të Komunës së Kamenicës.

5.2 MARRËVESHJA NDËRKOMUNALE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

Komuna e Kamenicës ka të nënshkuara disa marrëveshje ndërkomunale e nder institucionale. Nëse e analizojmë por edhe është konfirmuar se Komuna e Kamenicës rezulton që është një nga komunat që viteve të fundit e ka parë me interes bashkëpunimin Komunal. (Kastrati Q, Kryetar i Komunës së Kamenicës. Intervistë me datë 19.05.2019.) Deri tani Komuna e Kamenicës i ka të nënshkuara 7 marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunal e ndër institucional.

Marrëveshjet janë me tematikë dhe interesa të ndryshme që kanë pasur komunat nënshkruese.

5.3 MARRËVESHJA NDËRKOMUNALE NË MES TË KOMUNËS SË KAMENICËS DHE KOMUNËS SË GJILANIT

Marrëveshje në mes të këtyre dy komunave është e karakterit të bashkëpunimit në fushën e agroturizmit dhe të rinjve ne regjionin lindor. (Regjioni Lindorë i Kosovës, ndarje jo zyrtare për nevoja të identifikimit të projektit) Marrëveshja e mirëkuptimit është nënshkruar nga dy kryetarët e Komunave të Gjilanit dhe Kamenicës. (Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Kamenicës) Marrëveshja ka të bëjë me një projekt të përbashkët “Të rinjtë në agrobiznes” që është nënshkruar ne 2018 dhe do të zgjasë 22 muaj. Projekti është mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe ka për objektive të krijoj punësim fitimprurës për të rinjtë e komunave pjesëmarrëse ne projekt të regjionit ekonomik lindje. Ky projekt menaxhohet nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Komunat janë zotuar për mbështetje të programit.

Projekti synon që të arrij objektiva specifike në fushat si në vazhdim:

1. Sigurimin e mundësisë për të rinjtë në zonat rurale që promovojnë ndërmarrje inovative në fushën e bujqësisë dhe agro-turizmit.
2. Ngritjen e nivelit të aftësive në agrobiznes dhe mundësive ekonomike për të rinjtë në zonat rurale.
3. Avancimin e rrjeteve në agrobiznes për të rinjtë dhe sigurimin e shërbimeve interaktive të informimit.

4. Rritjen e vetëdijes për çështjet gjinore në mes të rinjëve dhe sigurimin e mundësive të barabarta në avancimin e grave të reja në agrobiznes.

Nga kjo marrëveshje në këtë projekt përfitues direkt do të jenë:

100 pjesëmarrës që do marrin trajnime praktike në punë, mbi 52 biznese të reja që do kenë rastin të marrin përkrahje financiare nga nen-grati që synon grupet e targetuara.

6 biznese aktuale të agro-përpunimit që do mbështeten për mundësimin e kushteve adekuate për programin e praktikave.

200 të rinjë do marrin trajnime në zhvillimin e aftësive në agro-biznes.

Sigurisht që nga ky projekt ka edhe një numër të personave që përfitojnë indirekt nga programi duke marrë trajnime e duke qenë të përfshirë në implementimin e tij që janë zyrtar komunalë e përfaqësues të tjerë lokal. (Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Kamenicës)

Kjo është një marrëveshje në proces dhe ende nuk kemi një vlerësim për rezultatet e saj, por çka mund të konstatojmë është që marrëveshjet e tilla i shërbejnë dinamikës së bashkëpunimit ndërkomunal dhe janë mundësi për rezultate të nevojshme që kanë për synim edhe realizimin e objektivave të palëve nënshkruese dhe të donatorit në këtë rast Bashkimit Evropian.

5.4 MARRËVESHJA E KOMUNËS SË KAMENICËS DHE RANILLUGUT

Bashkëpunimin me komunat e tjera Komuna e Kamenicës e ka zgjeruar edhe me komunën tjetër fqinje, me Komunën e Ranillugut. Kjo komunë që është në mesin e komunave që ka dalë nga procesi i decentralizimit dhe hyn në grupin e komunave të vogla nëse i ndajmë nga madhësia komunat e Kosovës. Ranillugu është komunë fqinje e Kamenicës dhe një pjesë të problemeve i ka të ngjashme me Kamenicën.

Në përpjekjen për të krijuar zgjidhje për problemin e ujërave të zeza Komuna e Kamenicës dhe Komuna e Ranillugut kanë bërë një marrëveshje për bashkëpunim sa i përket kësaj problematike.

Marrëveshja ndërmjet këtyre dy komunave është nënshkruar me datën 25.09.2018 nga kryetarët e Komunave, Qëndron Kastrati, të Kamenicës dhe Vladica Artonovic, të Ranillugut. Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin në përpjekjen për të gjetur fonde për projektin e ujërave të zeza, përkatësisht ndërtimin e impiantit dhe kolektorëve që është problem që i prekë këto dy komuna.

Nga kjo marrëveshje përkatësisht nenin 2 pika 2.1 komunat marrin vesh që bashkërisht të kërkojnë fondet e domosdoshme për ndërtimin e impiantit, të kolektorëve, si dhe trajtimin e ujërave të zeza në tërësi. ((Marrëveshje për bashkëpunim, e lidhur në Kamenicë, me datë 25.09.2018 në mes të Komunës së Kamenicës dhe Komunës së Ranillugut. Faqe 2.)

Palët janë pajtuar që i autorizuar për të zbatuar këtë marrëveshje deri në ndonjë vendim tjetër është kryetari i Komunës së Kamenicës. Marrëveshja parasheh nenet për zbatimin e saj apo edhe shkëputjen e saj nëse ka mospajtime në mes të palëve.

5.5 MARRËVESHJET E KOMUNËS SË NOVOBERDËS

Kjo marrëveshje ka për qëllim investimet e përbashkëta në infrastrukturë. Edhe Komuna e Novobërdës sikurse Komuna e Gjilanit dhe Parteshit janë komuna fqinjë të Komunës së Kamenicës dhe është interes vital përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës për qytetarët e këtyre komunave.

Marrëveshja me Komunën e Novobërdës është e bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale NR 03/ L-040 neni 28, Ligjin për Kufijt Administrativ të Komunave, NR 03/ L-41 neni 28. (Marrëveshje e mirëkuptimit për investime të përbashkët në rrugën Zmijarnik-Miganofc-Gogolofc-Kamenicë në mes të Komunës së Novobërdës të përfaqësuar nga kryetari i komunës Svetislav Ivanovic dhe Kryetari i Komunës së Kamenicës Qëndron Kastrati me datë 05.02.2018)

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit është protokolluar nga të dyja Komunat me datën 05.02.2018 në Novobërd dhe me datën 06.06.2018 në Komunën e Kamenicës. Si dokument i përgjigjet të gjitha kriterëve ligjore për bashkëpunim ndërkomunal në Republikën e Kosovës.

Marrëveshja e mirëkuptimit është arritur për investimin në infrastrukturën rrugore të përbashkët në rrugën Zmijarnik-Miganofc-Gogolofc-Kamenicë.

Kjo marrëveshje në pikën 2 të saj specifikon edhe zbatuesit e kësaj marrëveshje. Zbatimin e kësaj marrëveshjes e bënë Komuna e Novobërdës bashkë me Komunën e Kamenicës, udhëheqëse e këtij projekti është Komuna e Novobërdës, e cila edhe e kishte detyrë të aplikoj në fondet e Ministrisë për Zhvillim Rural në programin e fondeve për vitin 2018. (Po aty faqe 2)

Komuna e Kamenicës përveç marrëveshjeve ndërkomunale ka edhe disa marrëveshje ndërinstitucionale si ajo me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku me 24.07.2018 ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi për bashkëpunim në zbatimin e projektit “Kompleksi Rexhep Malaj” në fshatin Hogosht të Komunës së Kamenicës. Kjo është një marrëveshje për bashkëfinancim në realizimin e projektit në mes të dy institucioneve të Republikës së Kosovës.

Përveç Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Kamenicës ka marrëveshje edhe me Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve strategjike. Kjo marrëveshje është lidhur me qëllim realizimin e përbashkët të aktiviteteve për diasporën. Siç edhe specifikohet në nenin 1 të kësaj marrëveshje qëllimi i saj është: Organizimi i përbashkët i aktiviteteve kulturore, me qëllim të promovimit, ruajtjes, kultivimit të identitetit kulturorë, gjuhësorë të pjesëtarëve të diasporës, përmes koncertit festiv të diasporës. (Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve strategjike dhe Komunës së Kamenicës. Datë 23.07.2018)

Në nenin 2 dhe nenin 3 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi specifikohen detyrat që dalin nga kjo marrëveshje si për Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike po ashtu edhe për Komunën e Kamenicës.

Përveç marrëveshjeve të bashkëpunimit, memorandumëve të bashkëpunimit, Komuna e Kamenicës ka të nënshkruar edhe një marrëveshje mirëkuptimi për bashkëfinancim të projektit.

Me datën 09.08.2018 Komuna e Kamenicës ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për bashkëfinancim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kjo marrëveshje është nënshkruar për investimin në ujësjellësin në Kamenicë, rruga Tugjec. Në këtë marrëveshje specifikohen palët nënshkruese dhe obligimet që kanë ndaj njëra tjetrës dhe ndaj projektit.

Në nenin 8 të marrëveshjes me MMPH për investimin në ujësjellës është specifikuar pronësia e projektit pas përfundimit të projektit që në këtë rast është komuna e Kamenicës si dhe janë specifikuar detyrat gjatë realizimit të projektit nga projektimi, tenderimi e deri te pranimi teknik i projektit si pjesë e procedurës. (Po aty)

Përveç marrëveshjeve ndërkomunale dhe me institucionet qendërore Komuna e Kamenicës ka memorandum bashkëpunimi edhe me shoqata të shoqërisë civile në këtë rast me shoqatën Ekonomike Kulturore “Qëndresa Kosovare”. Kjo marrëveshje ka për synim dinamikën e bashkëpunimit dhe krijimin e kushteve për të realizuar aktivitetet kjo shoqatë.

Marrëveshja është nënshkruar me datë 08.10.2018 në Kamenicë në mes të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorit të organizatës.

Në nenin 1 të këtij Memorandumi të bashkëpunimit specifikohet qëllimi i bashkëpunimit, derisa në nenet pasuse 2 fushat e bashkëpunimit për të vazhduar pastaj me Obligimet që ka Komuna, kohëzgjatjen e marrëveshjes dhe mënyrën e shkëputjes së kësaj marrëveshje. (Memorandum Bashkëpunimi në mes të Komunës së Kamenicës dhe Shoqatës Ekonomike Kulturore “Qëndresa Kosovare” nënshkruar me datë 08.11.2018)

Me këtë memorandum me organizatën e shoqërisë civile po e mbyllim ciklin e analizimit të marrëveshjeve që ka Komuna e Kamenicës. Përveç bashkëpunimit ndërkomunal me qëllim për të parë më qartë mundësitë që kanë komunat për bashkëpunim edhe marrëveshjet me institucionet e nivelit qendëror por edhe shoqërinë civile.

Sigurisht që në këtë pjesë të punimit analizuam një pjesë të punës që ka bërë Komuna e Kamenicës sa i përket bashkëpunimeve ndërkomunale e ndërinstitutionale. Ne analizuam vetëm marrëveshjet që i kemi në dispozicion, por ka edhe shumë mënyra të bashkëpunimit që s’janë në formë të shkruar por që bëhen shpesh me qëllim të realizimit të detyrave që kanë Komunat dhe për sfidat që kanë komunat në zbatimin e Politikave Lokale.

5.6 KOMUNA E MALISHEVËS

Përmbledhje e shkurtër e disa karakteristika të përgjithshme të Komunës së Malishevës. Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 306.3 km². Ajo kufizohet: në veri me komunën e Klinës dhe të Drenasit, në lindje me komunën e Lipjanit, në jug me komunën e Therandës dhe të Rahovecit dhe në perëndim me komunën e Klinës.

Qendra komunale e Malishevës, si njësi administrative territoriale, përbëhet nga 39 njësi kadastrale dhe 44 vendbanime, përfshirë këtu edhe vetë qendrën komunale. (Komuna e Malishevës. Webfaqja Zyrtare. Datë: 05.04. 2019)

Sipas të të dhënave statistikore të regjistrimit të popullsisë Komuna e Malishevës ka mbi 70 000 banorë.

Që nga regjistrimi i vitit 1971 deri më sot, vlerësohet se popullsia e komunës së Malishevës është rritur për 26,320 banorë ose për 1,010 banorë në vit. Numri i përgjithshëm i familjeve është 8,450, me numër mesatar të anëtarëve për familje 7,7. Përderisa struktura nacionale është 99.9% shqiptarë dhe 0.1% komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas. (po aty)

Komuna e Malishevës është nënshkruese e një marrëveshje ndërkomunale me Komunitat Pejë, Klinë dhe Istog. Po ashtu është nënshkruese e tri marrëveshjeve për binjakëzime ndërkombëtare.

Komuna e Malishevës është e binjakëzuar me Komunën e Orhangazit në Turqi. Ky binjakëzim është nënshkruar në vitin 2009.

Ndërsa kemi bashkëpunim të mirë me komunën e Sundernit në Gjermani dhe me komunën e Meyrinit në Gjenevë-Zvicër. (Krasniqi B, Intervistë me shefen e kabinetit të Kryetarit të Komunës së Malishevës)

Nga këto marrëveshje Komuna e Malishevës ka përfituar disa donacione në shëndetësi. Duke e ditur që komunat tona kanë buxhet të vogël për investime kapitale dhe duke marrë parasysh kërkesat e mëdha për investime nga komuniteti bashkëpunimi ndërkomunal është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të investohet në projekte të përbashkëta në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve si dhe në rritjen e mundësive për përfitimin e projekteve dhe donacioneve nga organizata vendore e ndërkombëtare.

Sidomos bashkëpunimi i komunave fqinje është shumë i rëndësishëm bazuar në faktin që qytetarët e komunave kufitare shpesh marrin shërbime në komunat fqinje për shkak të afërsisë por edhe në çështje të tjera. (Po aty. Vlerësim i Krasniqi B)

Marrëveshja ndërkomunale që është e para e Komunës së Malishevës si marrëveshje në mes të 4 komunave apo marrëveshje shumëpalëshe në mes të Pejë, Istog, Klinë dhe Malishevë është nënshkruar me 09.10.2018.

Kjo marrëveshje është nënshkruar në përputhje me Ligjin nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale nenin 17 si dhe ligjin nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal në fushën e Ripërtërimit nga fatkeqësitë.

Kjo është marrëveshje në mes të më shumë se dy komunave dhe ka për qëllim bashkëpunimin në ngritjen e rrjetit për forcimin e aftësive ripërtërimit nga fatkeqësitë, sidomos në ngritjen dhe shkëmbimin e përvojave, projekteve me interes të përbashkët dhe promovimin e kuptimit e rrezeve të përbashkëta urbane dhe ndërkomunale si dhe ngritjen e vetëdijes publike për zvogëlimin e rrezeve nga fatkeqësitë. (Marrëveshje e bashkëpunimit ndërkomunal, palët nënshkruese komunat Pejë, Istog, Klinë dhe Malishevë. Marrëveshja është nënshkruar me datë 09.10.2018)

Qëllimi i kësaj marrëveshje është të që të definoj qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit organ veç e veç. (Po aty faqe 2)

Në këtë marrëveshje palët janë pajtuar që bashkëpunimi do të zbatohet në bazë të reciprocitetit dhe palët do të përfitojnë të gjitha nga kjo.

Sipas kësaj marrëveshje përzgjedhja e udhëheqësit të Rrjetit “Ripërtërimit nga fatkeqësitë Istog, Klinë, Malishevë dhe Pejë”, do të bëhet me rotacion nga komunat pjesëmarrëse me një mandat dy vjeçar. Për projekte specifike rrjeti do të emëroj përgjegjësin e projektit. (Po aty faqe 2)

Lënda e kësaj marrëveshje është zyrtarizmi i rrjetit “Ripërtërimit nga fatkeqësitë Istog, Klinë, Malishevë dhe Pejë” për forcimin e aftësive ripërtërimit urbane nga fatkeqësitë.

Komunat nënshkruese kanë të drejtat dhe detyrat e secilës pale të përshkruara në nenin 3 të kësaj marrëveshje. (po aty)

Ato janë të obliguara të bashkëpunojnë me projektin e UNDP-së dhe SEE-Urban,

Të emërojnë nga ana e Komunës anëtarët e rrjetit ripërtërimit nga fatkeqësitë,

Të zhvilloj dhe të impelmentojnë projekte të përbashkëta në fushën e fatkeqësive natyrore me një apo më shumë komuna anëtare të rrjetit lokal “Ripërtërimit nga fatkeqësitë”

Dhe në projektet e ardhshme do të caktohet përgjegjësi nga komuna udhëheqëse e projektit në përputhje me këtë marrëveshje.

Financimin e kësaj marrëveshje në bazë të nenit 5 i bartë projekti UNDP-së dhe SEE-Urban.

Në nenin 6 palët janë pajtuar për caktimin e përgjegjësve dhe krijimin e grupit të përbashkët që do të koordinojnë projektin nga komunat përkatëse.

Ndërsa mosmarrëveshjet në mes të palëve i zgjidhë gjykata kompetente. Marrëveshja ndërmjet palëve ka hyrë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL) që është përgjegjëse për vlerësimin e ligjshmërisë

të aktive Komunale. (Rregullore (MAPL) NR. 01/2017 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës. Neni 4 pika 1.4)

Marrëveshja është e përpiluar në 5 kopje, 4 kopje mbahen nga 4 komunat nënshkruese të marrëveshjes ndërsa 1 kopje e mbanë Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

Marrëveshjet ndërkomunale janë parë si mundësi nga zyrtarët përgjegjës edhe pse ende duhet të investohet në atë drejtim.

5.7 KOMUNA E SUHAREKËS

Disa karakteristika të përgjithshme për Komunën e Suharekës. Suhareka gjendet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajt dhe Shtërpçës.

Komunën e Suharekës, si njësi territoriale, e përbëjnë: qyteti i Suharekës, lagjet urbane dhe fshatrat. Territori i Komunës përfshinë Suharekën dhe këto 42 vendbanime. Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të vitit 2017, Komuna e Suharekës ka 41 vendbanime, ku jetojnë 88.126, banorë. (Komuna e Suharekës, <https://kk.rks-gov.net/suhareke/qyteti/numri-i-banoreve/>. Shikuar me datë 23.04.2019)

Nga hulumtimi për Komunën e Suharekës edhe pse gjendet në mesin e tetë komunave si territor që kufizohet, nuk kemi arritur të kemi ndonjë marrëveshje të shkruar që ka kjo Komunë.

Komuna e Suharekës ka pasur një përpjekje për bashkëpunim me Komunën e Rahovecit që janë edhe komuna fqinje sa i përket një zone për investime ekonomike, por për shkak të problemeve pronësore ka dështuar kjo iniciativë e bashkëpunimit ndërkomunal. (Intervistë me Leonard Shalen, Asambleist në Kuvendin Komunal të Suharekës. Intervista është realizuar me datën 09.04.2019)

5.8 KOMUNA E PRISHTINËS

Prishtina edhe pse është kryeqyteti i Kosovës dhe ka një potencial të madh për bashkëpunim ndërkomunal ka vetëm dy marrëveshje të shkruar ndërkomunale me Komunën e Obiliqit. Marrëveshja e parë është nënshkruar në vitin 2015 në mes të dy kryetarëve të Komunave të Prishtinës dhe Obiliqit. Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte “Ndërtimi i rrugës në fshatin Berrnicë e Ulët, në Prishtinë dhe fshatin Mazgit në Obiliq” (Marrëveshje Bashkëpunimi Komuna Prishtine dhe Obiliq për “Ndërtimi i rrugës në fshatin Berrnicë e Ulët, në Prishtinë dhe fshatin Mazgit në Obiliq, e nënshkruar me datë 25, Mars 2015)

Marrëveshja për projektin e ujësjellësit për fshatin Breznic dhe Kozaric të komunës së Obiliqit, dhe lagjes së Llumnicve dhe Barilevë të komunës së Prishtinës që është nënshkruar me 23.09. 2019. Marrëveshja është nënshkruar nga Kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, dhe nga ai i komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, dhe nga kompania e ujësjellësit “KUR Prishtina” Gjelo Vataj.(Komuna e Obiliqit. <https://kk-arkiva.rks-gov.net/obiliq/>)

Të tri këto institucione kanë ndarë përgjegjësitë për t’ua mundësuar këtyre dy fshatrave ujësjellësin.

Tek Marrëveshja për investimet në Infrastrukturë rrugore Komunit Prishtinë dhe Obiliq ishin pajtuar që të ndajnë kostot në proporcion me mundësitë financiare dhe kapacitetet humane që kanë në dispozicion.

Komuna e Prishtinës kishte marrë obligim investimin duke përfshirë tenderimin dhe procedurat edhe shpronësimet në territorin e saj, derisa Komunës së Obiliqit ishte obliguar të financonte projektimin dhe shpronësimet në territorin e saj.

Ky është një rast i investimit të përbashkët falë bashkëpunimit Komunal ku një komunë me potencial më të vogël financiar përfiton nga një marrëveshje ndërkomunale, në këtë rast nga Komuna e Prishtinës. (Marrëveshje Bashkëpunimi për “Ndërtimi i rrugës në fshatin Berrnicë e Ulët, në Prishtinë dhe fshatin Mazgit në Obiliq” Neni 2 dhe 3 i marrëveshjes)

Mbikëqyrja e këtij projekti është bërë nga të dyja palët në pajtim me nenin 4 te marrëveshjes. Palët ishin pajtuar për të vepruar në besueshmëri për të arritur objektivat e kësaj marrëveshje. (Po aty neni 4 i Marrëveshjes)

Komuna e Prishtinës përmes ndërmarrjeve lokale dhe rajonale mund të këtë edhe marrëveshje të tjera. Objekt studimi për ne kanë qenë këto dy marrëveshje që Komuna e Prishtinës kishte me Komunën e Obiliqit dhe Kompaninë e Ujësjellësit Rajonal “Prishtina” dhe Komunën e Obiliqit si marrëveshje tri palëshe.

Komuna e Prishtinës është e përfshirë në disa marrëveshje të tjera rajonale e binjakëzime ndërkombe. Në kapitullin për Unionin e Bashkive Shqiptare do e trajtojmë më gjerësisht bashkëpunimin e Prishtinës në këtë nivel të bashkëpunimit rajonal.

5.9 UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE

Unioni i Bashkive Shqiptare është një nismë apo një formë e bashkëpunimit ndërkomunal rajonal, në këtë rast është bashkëpunim ndërkomunal i komunave të shteteve të ndryshme por me karakter të disa karakteristikave të përbashkëta.

Në vitin 2016 Bashkia e Tiranës, Komuna e Prishtinës, e Tetovës, e Ulqinit dhe ajo e Preshevës mbajtën takimin e parë zyrtar në kryeqytetin e Shqipërisë të Unionit të Bashkive dhe Komunave Shqiptare të Rajonit. Takimi u hap nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili mbajti fjalën e mirëseardhjes dhe vuri në dukje se është në detyrimin e kryetarëve të bashkive dhe komunave që t'i përgjigjen pritshmërive të qytetarëve që drejtojnë për mundësi më të mira jetese. Ndaj, Unioni i Bashkive Shqiptare ka për qëllim të krijojë klimën dhe mekanizmat e duhura të bashkëpunimit mes qyteteve shqiptare në rajon. (Veliaj E, Kryetar i Tiranës, Tiranë 2017. <https://ëëë.tirana.al/artikull/mbahet-konferenca-e-pare-e-unionit-te-bashkive-dhe-komunave-shqiptare-ne-rajon>)

Ideja e këtij bashkëpunimi ndërkomunal me karakter rajonal është që ky bashkëpunim do t'i shërbejë në radhë të parë qytetarëve shqiptarë në të gjitha bashkitë dhe komunat shqipfolëse pjesëmarrëse dhe indirekt edhe të tjerave, pasi do të nisë si organizimin e bashkëpunimeve konkrete mes tyre, por edhe do të shërbejë për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira që kanë Komunitat nënshkruese të këtij bashkëpunimi.

Bashkëpunimi i tillë është pa shumë i vlefshëm edhe nga përfaqësuesit e Komunave pjesëmarrëse. "Ideja është që të kemi një forum diskutimesh, shkëmbime të përvojave dhe me një sekretariat të përhershëm, ku ne do të mund t'i ndajmë të mirat, e pse jo edhe të mësojmë nga gabimet. Është vënë për herë të parë një komunikim i drejtpërdrejtë i komunave shqiptare të të gjithë rajonit". (Ahmeti SH, Kryetar i Prishtinës, Intervistë për Radion Evropë e Lirë)

Në këtë marrëveshje për Unionin e Bashkive Shqiptare bëhet fjalë për një nismë që do të avancojë kauzën e shqiptarëve në mbarë rajonin, duke i ofruar qeverisje më të mirë lokale, shërbime më të mira, zgjidhje më të mira për jetesën në komunitet, cilësi më të mirë në të gjitha faktorët e jetës që preken nga puna e bashkisë.

Në bazë të marrëveshjes së firmosur në takimin e parë të zhvilluar në Tiranë, bashkitë angazhohen për të bashkëpunuar për thithjen e fondeve, të projekteve rajonale dhe ndërkufitare, ndonjëherë dhe duke aplikuar bashkë, aty ku mund të aplikohet, si dhe mbështetja e njëri-tjetrit me masa, asete, ekspertizë dhe personel në rast të emergjencave civile. (Unioni i Bashkive dhe Komunave Shqiptare mbledhet në Prishtinë, agjendë konkrete bashkëpunimi. <http://www.qarkutirane.gov.al/sq/lajme/unioni-i-bashkive-dhe-komunave-shqiptare-mbledhet-n>, Publikuar me datë: 20/02/2018)

Ideja fillestare ka qenë të shmangen ndarjet partiake, rajonale e ideologjike, por të promovohet shkëmbimi i përvojave dhe ndihma e njërit tjetrit për sfidat e qeverisjes lokale. Rruga është rrugë, si në Tiranë, si në Prishtinë, shkolla është shkollë, si si ne Cair si në Preshevë, si në Tetovë, një kopsht është një kopsht, si Prizren, si në Preshevë dhe një

infrastrukturë moderne dhe pastrimi i qytetit është e njëjta vlerë dhe shihet më rëndësi si në Vlorë e si në Ulqin.

Në frymën e idesë që këto sfida që janë karakteristika lokale të marrin zgjidhjet më të mira duhet një komunikim i shtuar e dinamik në mes të palëve nënshkruese por edhe Komunave tjera që do bashkohen pas konferencës së parë, dytë apo tretë dhe që vazhdon.

Nga diskutimet dhe vendimet edhe ne Konferencën e Tiranës 2016, edhe të Prishtinës 2018 por edhe të Tetovës në vitin 2019 rezulton se kjo nismë nuk është një projekt nacionalist.

Unioni i Komunave Shqiptare në rajon paraqet një lidhje të parë të këtij lloji që kanë ndërmarrë autoritetet lokale nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali e Zi dhe Lugina e Preshevës. (Artikull nga Arton Konosheci, Radio Europa e Lirë, Unioni i Komunave Shqiptare në Ballkan synon të zgjerohet, Datë 30 Nëntor 2016)

Ky është një projekt shumë pragmatik, që synon të rrisë bashkëpunimin mes shqiptarëve për të zgjidhur problemet e sfidat konkrete me të cilat përballen qytetet tona.

Gjatë takimit të vitit 2016 që është edhe takimi i parë themeltar i Unionit të Bashkive Shqiptare, bashkitë dhe komunat që janë pjesë e këtij Unioni nënshkruan edhe një platformë me 5 pika bashkëpunimi, që kanë të bëjnë me fusha të ndjeshme për jetën e qytetarëve, siç është urbanistika, mjedisi, arti dhe kultura, dhe inovacioni.

Këto 5 shtylla kryesore të bashkëpunimit praktik dhe pragmatik, që mbulojnë problemet kryesore me të cilat përballemi dhe në këto 5 shtylla janë edhe synimet për të ndërtuar një platformë bashkëpunimi për të ardhmen.

Këtij bashkëpunimi në takimin e Prishtinës në vitin 2018 i janë bashkuar edhe 3 qytete tjera dhe ka synim rritjen e numrit, por pa e dëmtuar cilësinë e bashkëpunimit.

Marrëveshja e Tiranës e nënshkruar nga kryetaret e komunave partnere parashikon krijimin e një platforme bashkëpunimi, e cila do t'u lejojë bashkive të rrisin shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës në fushat e urbanistikës, inovacionit, mjedisit, kulturës dhe formave të reja të financimit. Gjithashtu, përcaktohet ngritja e një Grupi të përhershëm kordinator që ka për detyrë të ndërmjetësojë në mënyrë të pandërprerë komunikimin dhe bashkëpunimin konkret mes bashkive për të gjitha fushat e parashikuara në memorandum apo çdo fushë tjetër me interes.

Marrëveshja parashikon shkëmbime të rregullta në nivel ekspertësh, përvoje dhe projektesh që kanë rezultuar të suksesshme, si dhe zhvillimin e rregullt të programeve të përbashkëta kulturore dhe artistike me një kalendar të unifikuar.

Aty përcaktohet angazhimi për të bashkëpunuar për thithjen e fondeve dhe të projekteve rajonale dhe ndërkufitare, ndonjëherë dhe duke aplikuar bashkë, aty ku mund të aplikohet, si dhe mbështetja e njëri-tjetrit me masa, asete, ekspertizë, dhe personel në rast të emergjencave civile.

Synimi i takimit të Tiranës dhe takimeve pasuse në Prishtinë dhe Tetovë është që përmes kësaj platforme bashkëpunimi, duke krijuar një sinergji mes Bashkive të Tiranës, Prishtinës, Tetovës, Ulqinit, Prizrenit, Fierit, Tuzit, Çairit dhe Preshevës, apo cilëso bashki shqiptare në rajon që do të dojë t'i bashkohet kësaj nisme, do të arrijmë të përdorim në mënyrë më efikase burimet njerëzore e financiare për të zgjidhur ato probleme që shqetësojnë realisht qytetarët dhe për t'i dhënë një dinamikë të madhe zhvillimit të hapësirës shqiptare në rajon.

5.10 TAKIMI I PRISHTINËS

Më 16 dhe 17 shkurt 2018 në Prishtinë, u mbajt takimi i dytë i Unionit të Bashkive Shqiptare të Rajonit, ku u diskutua kryesisht për ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Secila Komunë/Bashki, përmes përfaqësuesve të vet, prezantoi ide të ndryshme për Qytetin e Gjelbër, ide këto që çojnë tek zotimeve të përbashkëta për hapa konkret drejt zhvillimit të qyteteve më të pastra, të shëndetshme dhe të sigurta për qytetarët.

Delegacioneve në këtë konferencë iu prinë Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj; Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi; Kryetari i Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi; Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka; Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari; Nënkryetari i Komunës së Ulqinit, Arian Murati; Administratori i Përgjithshëm i Bashkisë së Fierit, Florjan Muçaj; si dhe nikoqiri, Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. (Takimi i dytë i Unionit të Bashkive Shqiptare në Prishtinë)

Në këtë takim po ashtu u diskutua për zgjerimin e mëtutjeshëm dhe mënyrën e funksionimit të këtij Unioni, për Sekretariatit e Unionit i cili qendrën do ta ketë në Tiranë, por do të përfshijë brenda vetes gjithnjë e më shumë Komuna/Bashki shqiptare të rajonit.

Në këtë Takim u nxjerr edhe një deklaratë. Deklarata përmban fushat e bashkëpunimit dhe synimet e unionit.

5.11 DEKLARATA E UNIONIT TE BASHKIVE SHQIPTARE

DEKLARATË

E UNIONIT TË BASHKIVE SHQIPTARE TË RAJONIT PËR KRIJIMIN E QYTETEVE TË QËNDRUESHME NËPËRMJET NISMAVE TË GJELBRA. (Deklarata e Unionit të Bashkive Shqiptare. Prishtinë, 17 shkurt 2018)

Ne, Kryetarët e Komunave, të Prishtinës, Preshevës, Tetovës, Ulqinit, Gostivarit, Prizrenit dhe Bashkive të Tiranës dhe Fierit, u mbledhëm me vullnetin e mirë për të vazhduar bashkëpunimin e fortë dhe afatgjatë të ‘Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon’.

U pajtuam mbi nevojën e ndërmarrjes së hapave për konkretizimin e objektivave të matshme për ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në kuadër të nismave për zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve tona.

Duke bashkuar forcat, duke mësuar nga përvojat e përbashkëta dhe duke mbështetur njëri-tjetrin zotohemi:

- Të rrisim sipërfaqet e gjelbra, nëpërmjet mbjelljes së përvitshme të pemëve në raportin 1 pemë për 10 banorë;
- Të nxisim përdorimin e biçikletave si mjete alternative dhe më të pastra transporti nëpërmjet:
 - Ndërtimit të shtigjeve të dedikuara dhe më të sigurta për biçikleta, në raportin 1 kilometër për 100.000 banorë;
 - Punës për ngritjen e sistemit ‘Bike & Share’, në raportin 1 biçikletë për 2500 banorë;
- Të përmirësojmë cilësinë e ajrit duke zhvilluar monitorime të vazhdueshme, me qëllim ruajtjen e parametrave mjedisore të vendosur nga Bashkimi Evropian;
- Të organizohet nisma “Dita pa Makina” në secilin qytet, në frekuencën 1 herë në 3 muaj (4 herë në vit) për të rritur ndërgjegjësimin qytetar në mbrojtjen e ambientit;
- Të punohet në përgatitjen e infrastrukturës së përshtatshme për furnizimin me energji të makinave dhe autobusëve elektrikë duke nxitur përdorimin e këtyre mjeteve ekologjike të transportit;

Jemi të bindur se nëpërmjet kësaj platforme bashkëpunimi duke krijuar sinergji mes bashkive dhe komunave tona mund të ecim më shpejt drejt zhvillimit të qyteteve më të pastra, të shëndetshme dhe të sigurta për qytetarët.

Prishtinë, 17 shkurt 2018

Komuna e Prishtinës	Bashkia Tiranë	Komuna e Tetovës
Shpend Ahmeti	Erion Veliaj	Teuta Arifi
Komuna e Preshevës	Komuna e Prizrenit	Komuna Gostivar
Shqiprim Arifi	Mytaher Haskuka	Arben Taravari
Komuna Ulqin	Bashkia Fier	
Arian Murati	Armando Subashi	

Në këtë deklaratë shihen disa nga përpjekjet e përbashkëta të Komunave për zhvillimin e politikave lokale me interes të zhvillimit dhe rezultateve më të mira për qytetarët dhe qytetet.

Nga Konferenca themeltare e Tiranës shihet një zgjerim i Unionit të Bashkive Shqiptare.

Pas Takimit të Prishtinës Unioni ka mbajtur edhe takimin e radhës në Tetovë. Pra kemi një rotacion të zhvillimit të punimeve në komunat anëtare.

5.12 TAKIMI I TETOVËS

Në takimin e tretë të Unionit të Bashkive Shqiptare që u mbajt me 12 dhe 13 prill 2019 u bë zyrtarizmi i kësaj iniciative përmes themelimit të sekretariatit të përgjithshëm i cili u vendos të regjistrohet në Tiranë. Ky trup formal i cili do të ketë rolin e organizatës jofitimprurëse do të bëjë koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta. (Sylejmani M, Pjesëmarrëse e takimit të Tetovës, Intervistë, Datë 20.05.2019)

Kryetarët e Komunave pjesëmarrëse të Unionit të Bashkive Shqiptare në rajon duke përfshirë edhe komunat e reja anëtare si Çairi, Tuzi, Vlora u zotuan për mbarëvajtjen e këtij sekretariatit të përbashkët të delegojnë nga një administrator nga secila komunë të cilët do të angazhohen për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta të Unionit të Bashkive dhe Komunave në Rajon. (Komunikatë e përbashkët e Unionit të Bashkive dhe Komunave Shqiptare, 13 prill 2019 Tetovë)

Kryetarët e u zotuan për funksionalizim të sekretariatit brenda vitit 2019. Po ashtu u pajtuan që sekretariati të organizoj të paktën dy takime tematike të Unionit brenda vitit.

Pra nga ideja, takimi i par deri te takimi i dytë dhe në takimin e tretë ka pasur një zgjerim në numrin e anëtarëve të Unionit por edhe konkretizim tematik e dakordim për funksionalizim administrativ.

Gjatë takimit të Tetovës, Qyteti i Tirana përmes Kryetarit të saj prezantoi edhe disa nga nismat e ndërmarra nga Bashkia e Tiranës si korsetë e biçikletave, Pylli Orbital etj., të cilat

kanë pasur një ndikim pozitiv në mjedis dhe shihen si mundësi për t'i adaptuar në Komunat tjera.

Përfaqësuesi i Tiranës shprehu nevojën e një integrimi më të mirë të qyteteve dhe për nxitjen e projekteve të përbashkëta. “Në Tiranë kemi filluar një projekt ambicioz për të mbjellë 2 milionë pemë. E pamundur t'i bësh të gjitha njëherësh, ndaj kemi thënë të mbjellim nga 100-150 mijë në vit deri në 2030. Nëse secili fëmijë e mbjell diçka për ditëlindje, fare mirë mund të bëhet në Tetovë dhe në qytete të tjera. Ambicja jonë është që nën suazën e integritit dhe të Bashkimit Evropian, ndoshta ka ardhur koha për t'u integruar mes veti njëherë, pastaj për t'u integruar me të tjerët”. (Veliaj E. Kryetar i Bashkisë së Tiranës. Report Tv - Unioni i Bashkive Shqiptare, Veliaj: Ka ardhur koha për t'u integruar mes veti. 13 Prill 2019)

Një nga detyrat e Sekretariatit që u vendos në takimin e Tetovës do të jetë edhe aplikimi në organizma të ndryshëm financiar për realizimin e projekteve rajonale.

Angazhimi i kryetarëve është që ky sekretariat të aplikojë për bashkëpunime, për projekte rajonale, ku ne mund të konkurrojmë për financime që ndihmojnë financimet e komunave nënshkruese, pjesë e këtij unioni.

Financimin e sekretariatit që do të jetë bartës i koordinimit dhe mbarëvajtjes së punëve me qendër në Tiranë do ta bëjnë komunat pjesëmarrëse në këtë union. (Ahmeti Sh, deklaratë për Radion Evropa e Lirë. Datë: 30 Nëntor 2016)

5.13 ANALIZA E REZULTATEVE

Praktika e deritanishme në Republikën e Kosovës tregon që bashkëpunimi ndërkomunal edhe pse shihet me rëndësi nga vendimmarrësit nuk ka pasur një dinamikë të madhe të zhvillimit si praktikë.

Aktualisht në Kosovë nuk ka një traditë për të krijuar një bashkëpunim ndërkomunal të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në shumë projekte që do të ishin mundësi e mirë për zhvillimin e politikave në interes të Komunave.

Nga praktikat e deritanishme në Komunitet e Kosovës ekzistojnë forma të ndryshme bashkëpunimi që mund të ndahen në dy grupe: Marrëveshje për investime të përbashketa sic janë rasti i Kamenicës me Novobërden apo Prishtinës me Obiliqin dhe Marrëveshje për shkëmbim përvojash, sic është rasti me Komunitet Pejë, Istog, Klinë dhe Malishevë për rrjetin “Ripërtëritja nga fatkeqësitë”.

Në praktikat që janë hulumtuar shihen Marrëveshje që kryesisht kanë të bëjnë me një tematikë, nuk ka marrëveshje ndërkomunale që mbulon disa fusha dhe që ka karakter afatgjatë.

P.sh. Marrëveshje e shërbimeve - ku një Komunë siguron shërbime publike për një zonë më të gjerë duke përfshirë njësi të përafërta gjeografike, përjashtojnë ndërmarrjet rajonale (p.sh një Komunë mund të shtrijë menaxhimin e mbetjeve urbane në një komunë fqinje përkundrejt një tarife apo edhe shërbime të tjera për një pjesë apo edhe gjithë territorin e komunës tjetër.)

Marrëveshjet ndërkomunale që janë analizuar kryesisht janë me disa nene të përgjithësuara dhe nuk kanë aneks marrëveshje të detajuara të marrëveshjes, nuk përshkruhen kostot, nuk ka dinamikë të zbatimit të precizuar saktë, në disa prej tyre dhe nuk ka analizë për pritjet apo mundësitë që krijon një bashkëpunim ndërkomunal.

Ka tre aspekte të rëndësishme që konsiderohen kur përcaktohen funksionet e një bashkëpunimi ndërkomunal. Së pari ky model nuk është ekskluziv vetëm për dy palë, por edhe për partner të tjerë. Së dyti njësitë e qeverisjes komunale duhet të jenë fleksibil në zgjedhjen e partnerëve dhe të iniciativave të bashkëpunimit ndërkomunal që mund të marrin pjesë në të. P.sh. e njëjta komunë mund të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me komunën fqinje për furnizimin me ujë, mund të marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët për menaxhimin e mbetjeve urbane me një numer komunash të tjera dhe mund të jetë pjesë e një projekti për turizmin.

Së treti, një mangësi e mundshme e këtij bashkëpunimi është mbivendosja e funksioneve dhe përgjegjësia e limituar që duhet të adresohet në iniciativa bashkëpunimi për të mos i bërë gjërat më keq duke vendosur më shumë presion mbi njësitë e dobëta lokale dhe rritjen e korrupsionit.

Aspektet financiare të bashkëpunimit ndërkomunal dhe funksionet e partneritetit. Partneriteti duhet të krijohet: në një nivel administrativ, midis dy niveleve të ndryshme administrative. Eksperienca ndërkombëtare tregon që qeverisja qendërore është më shumë e dëshiruar të alokojë burime financiare direkt partneritetit kur anëtarët janë nga nivele të ndryshme qeverisëse.

Nga këto praktika kemi ardhur në përfundim se Komunitat mund të kenë projekte të suksesshme nëse bashkëpunimin ndërkomunal e përfshinë si politikë që rritë mundësitë për ato.

Nga marrëveshjet e analizuar është pa që ka pas një tejkalim të ndarjeve partiake e ideologjike, etnike e rajonale. Sigurisht që problemet lokale nuk janë probleme të garës në mes të palëve por si probleme që duhet gjetur zgjidhje nga vendimmarrësit lokal përmes një bashkëpunimit për të dhënë zgjidhje të qëndrueshme për komunitetet.

6.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në vazhdim do të përmendim disa nga mundësit që kanë Komunitat e Kosovës në Projektet Ndërkomunale.

Duke e ditur faktin që nxitja për një bashkëpunim ndërkomunal mund të jetë vullnetar ose nga poshtë –lart apo lart-poshtë vijmë në përfundim që Komunitat duhet të shohin interes përfshirjen në bashkëpunime të tilla.

Nga hulumtimi rezulton se komunitat e Kosovës kanë një sërë temash që mund të përfshijnë në bashkëpunimin ndërkomunal.

6.1 SHKËMBIMI I PËRVOJAVE

Shumë Komuna të vogla jo rrallë ballafaqohen me fenomene që nuk janë karakteristika të tyre. Shembull ndërtimet e larta. Një marrëveshje me komunitat, të cilat i kanë përditshmëri këto fenomene mund t'i ndihmojë për një ballafaqim më profesional që do t'i kursente shumë kohë, shumë financa por edhe zhvillim brenda ligjit planeve urbane.

Në vitin 2013 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kaluar Ligjin për planifikim dhe Ligjin për ndërtime ku ka përcaktuar format e reja të planifikimit për komunitat. Planet Zhvillimore Urbane janë zëvendësuar me Hartat Zonale të cilat paraqesin një plan rregullativ të përgjithshëm. Shumica e komunave kanë nevojë për një qasje të re dhe dije të reja në këtë drejtim.

Duhet shkëmbyer përvojat e komunave më të mëdha apo edhe komunave që kanë ecur me shpejt në adaptimin e rregullativës së re. Komunitat përmes marrëveshjeve ndërkomunalë mund të përfitojnë shumë. Praktika që duhet adaptuar është modeli i hartave zonale të përpiluara në bashkëpunim më qytetarë, më grupet e interesit, me shoqërinë civile dhe me ekspertet.

Shembull të organizojë takime me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Inspeksionin të një komune që ka pasur rezultate të mira dhe të barten ato përvoja edhe në komunitat tjera. Të mbaj komunikim ndërmjet profesionistëve të fushës dhe të këtë forume profesionale që ndajnë përvojat.

6.2 REFORMA SEKTORIALE

Sektori i arsimit

Një marrëveshje me një komunë që ka ndërmarr një reformë në sektorin e arsimit për racionalizimin e shfrytëzimit të objekteve, kostove apo edhe stafit do t'i shërbente një komunë me karakteristika të njëjta shumë. Praktika e mirë në një komunë që ka funksionuar që ka karakteristika të përafërta, lehtësisht mund të bartet përmes një dinamike shkëmbimesh e komunikimesh në një komunë tjetër.

6.3 REFORMA NË DIGJITALIZIMIN E ADMINISTRATËS

Shembull suksesi është rasti me E-Kisosqet ku pas Komunës së Prishtinës edhe shumë komuna të tjera e kanë bartur këtë model. Apo modeli i organizimit të punës në zyret që kanë palë në administratat komunale. Apo trajnimi i stafit dhe organizimi i brendshëm duke bërë vlerësim e rivlerësim të resurseve humane janë shembuj që lehtësisht mund të adaptohen në komunat që përgjithësisht ballafaqohen me probleme të njëjta.

6.4 DOKUMENTACIONET DHE PERKTHIMET

Jo rrallë shumë komuna obligohen të trajtojnë e përkthejnë një dokument nga një gjuhë në gjuhën e përdorimit masivë. Me një marrëveshje ndërkomunale lehtësisht mund të ndahen detyra në këtë drejtim që do t'i kursente shumë kohë, financa dhe resurse një apo disa komunave të tjera.

6.5 MARRËVESHJET PËR INVESTIME TË PËRBASHKETA

Përmes një marrëveshje dy apo më shumë komuna mund të përfshihen në investime të përbashkëta që u japin zgjidhje problemeve që kanë. Bashkëpunim në hapjen e degëve të shkollave profesionale ku përmes institucioneve qendrore dhe lokale dy apo me shumë komuna mund të fusin në agjendë një apo disa degë të shkollave që i nevojiten nevojave të tregut dhe ekonomisë së një zone të caktuar.

6.6 INVESTIMET NË INFRASTRUKTURË

Marrëveshje për mirëmbajtje të përbashkët të rrugëve që lidhin komunat apo edhe fshatrave fqinje. Jo rrallë me lehtë e ka një komunë mirëmbajtjen e një rruge të një fshati se sa Komuna që është pjesë e tij fshati apo lagjia në fjalë. Me një marrëveshje ndërkomunale mund të rritet efikasiteti i shërbimit por edhe të ulen kostot. Infrastrukturë më e mirë dhe ndërlidhja në mes të komunave do të ndikonte në rritjen e ndërveprimit, shkurtimin e distancave, uljen e kostove për qytetarët dhe mundësinë për zhvillimin e degëve të caktuara ekonomike.

6.7 MBROJTJA E MJEDISIT

Mbrojtja e mjedisit është një nga sfidat më serioze që kanë komunat sot. Përmes bashkëpunimit ndërkomunal mund të arrihen marrëveshje për mbrojtjen e lumenjve që kalojnë në disa komuna, mbrojtjen e ujërave që furnizohen me ujë disa komuna. Mbrojtjen e florës dhe faunës. Pastaj marrëveshje për investime të përbashkëta që kanë qëllim mbrojtjen e mjedisit. Në deponitë e përbashkëta. Në praktika më të mira të menaxhimit të ujit dhe në investime të përbashkëta në kolektor e impiante për trajtimin e ujërave të zeza.

6.8 QASJA NË FONDE

Praktika e deritanishme ka treguar që po pati një seriozitet në bashkëpunim ndërkomunal që ka qëllime serioze në projekte, mundësia për të marr një donacion ndërkombëtar por edhe të brendshëm për një projekt përmes bashkëpunimit ndërkomunal është më e madhe.

6.9 INVESTIME NE PAISJE DHE TEKNOLOGJI

Shumë pajisje që kanë karakter të përdorimit të rrallë mund të blihen bashkë dhe të shfrytëzohen sipas nevojave që kanë komunat. Në kohën e digjitalizimit ku teknologjia ka risi të shpeshta investimi i përbashkët në aplikacione të caktuara mund t'i kursejë shumë financa por edhe shkëmbim përvojash e staf që përdor atë teknologji. Komunikimet e shpejta elektronike sot mundësojnë që shumë punë të kryhen online dhe orientimi i stafeve në këtë drejtim do të rriste efikasitetin dhe rezultatet në punë.

6.10 BASHKËPUNIMI NË TURIZËM

Duke qenë një vend i vogël Kosova komunat mund të bashkëpunojnë shumë në fushën e turizmit. Guidat e përbashkëta, infrastruktura e përbashkët, promovimi i vlerave si mundësi e turizmit në disa qytete është shans për rezultate të mira për komunat.

Strategjitë e përbashkëta dhe përparësitë që kanë secila komunë në një pjesë të këtij sektori do t'i ndihmonte shumë në tërheqjen e sa më shumë vizitorëve. P.sh. Kisha Ortodokse në Graçanicë dhe Xhamia me minaren e Gurit në Prishtinë dhe të gjitha objektet tjera të kultit në këtë regjion kanë një distancë të vogël do të ishin shumë interesante për një vizitor që ka dëshirë të shohë trashëgiminë kulturore të Kosovës Islame dhe atë Ortodokse. Por nëse s'ka një marrëveshje për promovim më të rajonalizuar gjasat janë të mëdha që një turist pas vizitës në Prishtinë të kthehet më "i varfër" sa i përket njohjes me historinë fetare të Kosovës dhe të qëndrojë më shkurt në Kosovë. Resurset natyrore si Ujëvara e Mirushes që gjendet në mes të Komunave Malisheve, Kline, Gjakove dhe Rahovec është mundësi për të gjitha këto komuna që ta promovojnë në listat e objekteve që një turist mund ti vizitoj.

Marrëveshje për ndërtimin e shtigjeve të përbashkëta për ecje dhe çiklizëm dhe mirëmbajtjen e tyre etj.

Këto ishin vetëm disa nga fushat ku bashkëpunimi ndërkomunal mund të ndihmojë në zhvillimin e politikave publike komunale. Sigurisht që ka shumë fusha të tjera që komunat e

Kosovës mund të bashkëpunojnë me qëllim të rritjes së performancës së tyre duke dhënë shërbime më të mira publike, kosto më të ulët për shërbime, por edhe rritje të kohezionit shoqëror e kombëtar në vend.

6.11 PËRMBLEDHJE

Në këtë hulumtim është trajtuar një segment i Bashkëpunimit Ndërkomunal. Nuk janë trajtuar asociacionet si forma të Bashkëpunimit Ndërkomunal e as organizatat rajonale që merren me këtë pjesë të politikave lokale e as bashkëpunimi joformal i brendshëm dhe i jashtëm që ndodh në mes të komunave.

Ky punim ka trajtuar bashkëpunimin ndërkomunal në Kosovë, format e bashkëpunimit ku përmes një mostër që ka përfshirë disa komuna, ka trajtuar nivelin e bashkëpunimit, marrëveshjet ndërkomunale dhe Unionin e Bashkive Shqiptare si praktikë e re e bashkëpunimit.

Një pjesë e këtij punimi ka trajtuar edhe kompetencat që kanë komunat dhe rregullativen ligjore ku bazohet Bashkëpunimi Ndërkomunal në Kosovë.

Ku hulumtim është vetëm një përpjekje modeste për ta trajtuar këtë temë që është shumë më rëndësi për zhvillimin e demokracisë lokale, por edhe rritjen e bashkëpunimit, produktivitetit të komunave dhe rritjen e kohezionit shoqërorë.

REFERENCAT

1. Erhard Epler, “Rikthimi i Politikës”, ISPS dhe Rinia 2000, Tiranë.
2. Council of Europe Publishing: “European Charter of Local Self – Government”.
3. Council of Europe, “Balancing Democracy, Identity and Efficiency: Changes in local and regional structures in Europe”.
https://www.ccre.org/en/papiers/index_broch/8/page:2
4. Eoin Young dhe Lisa Quinn. “Writing Effective Public Policy Papers”. Budapest, OSI/LGI, 2002 isbn: 9639419397
5. Bekim Baliqi, “Politikat Publike dhe Qeverisja”. Prishtinë: Fondacioni Konrad-Adenauer.
6. <https://www.kosovo-mining.org/kosova/gjeografia/>.
7. Komuna e Prishtinës e prezanton si model platformën "open data" tek ekzekutivi dhe asambleistët e Komunës së Gjilanit.
<http://www.prishtinaonline.com/kerkimi/953/komuna-e-prishtines-e-prezanton-si-model-platformen-open-data-tek-ekzekutivi-dhe-asambleistet-e-komunes-se-gjilanit>.
8. KDI: Komuna e Prishtinës më transparentja. <https://klankosova.tv/kdi-komuna-e-prishtines-me-transparentja/>
9. Radio Europa e Lirë. Vlerësime pozitive për zgjedhjet në Kosovë. <https://www.evropaelire.org/a/be-me-vleresim-pozitiv-per-zgjedhjet-lokale-/28813116.html>
10. Kuvendi i Kosovës: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”,
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
11. Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal. <https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf>
12. RREGULLORE NR. 2000/45 MBI VETËQEVERISJEN E KOMUNAVE TË KOSOVËS. http://ëëë.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_45.pdf
13. Ligji për Vetëqeverisje Lokale.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>
14. https://www.ccre.org/en/papiers/index_broch/8/page:2

15. Manual/Toolkit on Inter-municipal Cooperation, (UNDP, Council of Europe, Local Government and Public Service Reform Initiative, 2010). http://www.municipal-cooperation.org/images/4/4c/IMC_Toolkit_Manual.pdf
16. LIGJI NR. 04/L-010 PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2749>
17. Blerta Krasniqi, Shefe e kabinetit të Kryetarit të Komunës së Malishevës. Intervistë e realizuar me datë: 10. Qershor 2019, Malishevë.
18. Komuna e Kamenicës, ëeb faqja zyrtare.
<https://kk.rks-gov.net/kamenice/qyteti/historiku/>
19. Qëndron Kastrati – Kryetar i Komunës Kamenicës. Intervistë, datë 19.05.2019.
20. Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Kamenicës. Të rinjët në Agro-biznes, regjioni ekonomik lindor.
21. Marrëveshje për bashkëpunim, e lidhur në Kamenicë në mes të Komunës së Kamenicës dhe Komunës së Ranillugut.
22. Marrëveshje e mirëkuptimit për investime të përbashkët në rrugën Zmijarnik-Miganofc-Gogolofc-Kamenicë në mes të Komunës së Novobërdës të përfaqësuar nga kryetari i komunës Svetislav Ivanovic dhe Kryetari i Komunës së Kamenicës Qëndron Kastrati
23. Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve strategjike dhe Komunës së Kamenicës.
24. Memorandum Bashkëpunimi në mes të Komunës së Kamenicës dhe Shoqatës Ekonomike Kulturore “Qëndresa Kosovare”
25. Komuna e Malishevës. Ëebfaqja zyrtare.
<https://kk.rks-gov.net/malisheve/qyteti/numri-i-banoreve/>
26. Marrëveshje e bashkëpunimit Ndërkomunal, palët nënshkruese komunat Pejë, Istog, Klinë dhe Malishevë.
27. RREGULLORE (MAPL) NR. 01/2017 PËR PROCEDURËN E HARTIMIT DHE PUBLIKIMIN E AKTEVE TË KOMUNËS. Neni 4 pika 1.4. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15184>
28. Komuna e Suharekës, <https://kk.rks-gov.net/suhareke/qyteti/numri-i-banoreve/>.
29. Intervistë me Leonard Shalen, Asambleist në Kuvendin Komunal të Suharekës.

30. Marrëveshje Bashkëpunimi për “Ndërtimi i rrugës në fshatin Berrnicë e Ulët, në Prishtinë dhe fshatin Mazgit në Obiliq.
31. Komuna e Obiliqit. <https://kk-arkiva.rks-gov.net/obiliq/Neës/Komuna-e-Obiliqit,-ajo-e-Prishtines-dhe-Ujesjelles.aspx>
32. Erion Veliaj-Kryetari i Tiranës, Tiranë 2017.
<https://www.tirana.al/artikull/mbahet-konferenca-e-pare-e-unionit-te-bashkive-dhe-komunave-shqiptare-ne-rajon>.
33. Shpend Ahmeti –Kryetar i Prishtinës, Intervistë për Radion Evropa e Lirë. <https://www.evropaelire.org/a/28148497.html>
34. Unioni i Bashkive dhe Komunave Shqiptare mbledhet në Prishtinë, agjendë konkrete bashkëpunimi. <http://www.qarkutirane.gov.al/sq/lajme/unioni-i-bashkive-dhe-komunave-shqiptare-mbledhet-n%C3%AB-prishtin%C3%AB-axhend%C3%AB-konkrete-bashk%C3%ABpunimi>.
35. Artikull gazetaresk nga Arton Konosheci, Radio Europa e Lirë, Unioni i Komunave Shqiptare në Ballkan synon të zgjerohet, Datë 30 Nëntor 2016. <https://www.evropaelire.org/a/28148497.html>
36. Takimi i dytë i Unionit të Bashkive Shqiptare në Prishtinë. [https://kk-arkiva.rks-gov.net/prishtina/Neës/Takimi-i-dyte-i-Unionit-te-Bashkive-Shqiptare--\(1\).aspx](https://kk-arkiva.rks-gov.net/prishtina/Neës/Takimi-i-dyte-i-Unionit-te-Bashkive-Shqiptare--(1).aspx).
37. Deklarata e Unionit të Bashkive Shqiptare. Prishtinë, 17 shkurt 2018.
38. Intervistë Mimoz Sylejmani, Pjesëmarrëse e takimit të Tetovës.
39. Komunikatë e përbashkët e Unionit të Bashkive dhe Komunave Shqiptare, 13 prill 2019 Tetovë.
40. Erion Veliaj-Kryetar i Bashkisë së Tiranës. Report Tv - Unioni i Bashkive Shqiptare, Veliaj:
Ka ardhur koha për t’u integruar mes veti. <https://www.youtube.com/ëatch?v=6Sm2hievZ8Q>
13 Prill 2019.
41. Shpend Ahmeti, deklaratë për Radion Evropa e Lirë. <https://ëëë.evropaelire.org/a/28148497.html>. Datë: 30 Nëntor 2016.